



KORRUPSIONI NGA ANA E OFERTËS PERSPEKTIVA E BIZNESEVE

MAJ 2019



KORRUPSIONI NGA ANA E OFERTËS

**PERSPEKTIVA
E BIZNESEVE**

MAJ 2019

**Autorët:**

Muhamet Mustafa, Këshilltar i lartë,
Diellza Gashi, Drejtoreshë programore,
Gent Beqiri, Menaxher i zyrës së statistikave, dhe
Sejdi Osmani, Konsulent për aspektet ligjore

Originali është shkruar në gjuhën angleze

Publikuar nga:

INSTITUTI RIINVEST
Lidhja e Prizrenit nr. 56
Prishtina 10000, Republika e Kosovës
Tel: + 381 (0)38 244320; 223816
www.riinvestinstitute.org

Copyright © 2019 by INSTITUTI RIINVEST. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në ndonjë sistem për ruajtje, apo të bartet, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE REKOMANDIMET	6
1. HYRJE	8
2. KORRUPSIONI NGA ANA E OFERTËS DHE PASOJAT E TIJ	10
3. ASPEKTET DHE ZBRAZËTIRAT LIGJORE	13
3.1 Korniza ligjore në vendet e rajonit	15
4. PRAKTIKAT RELEVANTE NDËRKOMBËTARE	17
5. PËRCEPTIMI I BIZNESEVE LIDHUR ME KORRUPSIONIN NË PËRGJITHËSI DHE KORRUPSIONIN NGA ANA E OFERTËS NË VEÇANTI.....	20
5.1. METODOLOGJIA E ANKETIMIT.....	20
5.2. ANALIZA DHE PREZANTIMI I TË DHËNAVE	21
5.2.1 Profili i bizneseve	21
5.2.2 Vetëdijesimi dhe perceptimi i bizneseve kosovare lidhur me korrupsionin.....	22
5.2.3 Vetëdijesimi për pasojat	27
5.2.4 Origjina (burimet) e korrupsionit.....	27
5.2.5 Përvoja e bizneseve me korrupsion.....	31
5.2.6 Sjellja e bizneseve ndaj korrupsionit dhe gatishmëria për ti implementuar principet etike.....	34
6. PËRFUNDIME MBI TË GJETURAT E ANKETËS.....	41
7. DISPOZITAT KYÇE TË KODIT TË BIZNESIT KUNDËR KORRUPSIONIT	43
8. REFERENCAT	45



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE REKOMANDIMET

Qëllimi i këtij raporti është të rrisë ndërgjegjësimin e akterëve kryesorë në komunitetin e biznesit në Kosovë mbi rëndësinë e respektimit të parimeve etike në bërjen e biznesit me qëllim të reduktimit të korrupsionit dhe ryshfetit nga ana e bizneseve (korrupsioni nga ana e ofertës) përmes ushtrimit të zero tolerancë kundër praktikave korruptive. Raporti është përgatitur duke u bazuar në hulumtimin dytësor lidhur me identifikimin e boshllëqeve të legjisllacionit vendor në trajtimin e kësaj çështjeje, në eksplorimin e përvojave ndërkombëtare dhe gjithashtu në bazë të rezultateve të një ankete të realizuar me 500 biznese dhe intervista të mbajtura në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Agjencinë Kundër Korrupsionit të Kosovës.

Në angazhimet kundër korrupsionit në Kosovë, ana e ofertës të korrupsionit është neglizhuar, sidomos ana e ofertës nga sektori i biznesit. Në përgjithësi, të anketuarit (pronarët e bizneseve dhe menaxherët) pajtohen se korrupsioni në Kosovë është i përhapur, se paraqet probleme serioze për të bërë biznes veçanërisht lidhur me prokurimin publik dhe marrjen e licencave. Megjithatë, ato e reduktojnë këtë perceptim në mënyrë të konsiderueshme kur bëhet fjalë për vlerësimin e situatës në sektorin që ata veprojnë, ose përvojat e tyre. Ata gjithashtu konsiderojnë se korrupsioni është nxitur kryesisht nga interesat e ngushta të grupeve të caktuara politike. Bizneset janë të vetëdijshme për pasojat negative që lidhen me një sërë çrregullimesh në

treg si ndikimi negativ në vëllimin dhe destinacionin e investimeve publike dhe rritjen ekonomike, nxitshmangien e taksave, shkatërron imazhin dhe kredibilitetin e një vendi dhe ul investimet në shëndetësi dhe arsim, stimulon papunësinë dhe pabarazinë, respektivisht varfërinë. Sa i përket përgjegjësisë për situatën aktuale të krijuar, të anketuarit konsiderojnë zyrtarët publikë përgjegjës kryesorë, megjithatë ata gjithashtu deklarojnë se korrupsioni është gjithashtu i ndikuar nga gatishmëria nga ana e bizneseve për të pranuar kërkesën për ryshfet ose për të ofruar ryshfet në këmbim të profiteve apo kontratave fitimprurëse. Udhëheqësit e anketuar shprehën gatishmëri të lartë për të nënshkruar Kodin e Biznesit kundër Korrupsionit dhe për të zhvilluar masa dhe rregullore të brendshme kundër korrupsionit. Megjithatë, bizneset ende nuk kanë besim se sistemi gjyqësor angazhohet seriozisht dhe në mënyrë rigorozë për të luftuar këtë fenomen negativ.

Edhe pse ekziston një kornizë ligjore bazë që adreson korrupsionin, bazuar në përvojat e vendeve të tjera, rezultatet e anketës dhe hulumtimet sekondare, ne konsiderojmë se ekziston një hendek në legjisllacion në adresimin e përgjegjësisë së kompanisë së përfshirë në praktikat korruptive dhe gjithashtu në aspektin e monitorimit të zbatimit të kontratave të prokurimit publik në lidhje me cilësinë dhe sasinë e mallrave dhe shërbimeve të dorëzuara.

Bazuar në rezultatet e hulumtimit, ne rekomandojmë:

- Asociacionet e biznesit dhe udhëheqësit e bizneseve duhet të angazhohen në zhvillimin e politikave të brendshme dhe procedurave të cilat do të shërbejnë si kode të sjelljes për punonjësit, në të cilat shprehet qartë angazhimi i pronarëve, drejtuesve dhe të gjithë të punësuarve drejt standardeve të integritetit. Standarde të tilla si: të bërit biznes në mënyrë të drejtë, të sigurtë dhe të hapur për një mjedis të pastër biznesi.
- Asociacionet e biznesit duhet të angazhohen në mënyrë aktive në përgatitjen, nënshkrimin dhe zbatimin e Kodit të Biznesit Kundër Korrupsionit gjatë këtij viti. Çdo shoqatë biznesi duhet të krijojë një grup punues i cili do të jetë përgjegjëse për të monitoruar zbatimin e Kodit të Biznesit Kundër Korrupsionit nga bizneset që janë anëtarë në asociacionet përkatëse.
- Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës duhet të angazhohen në ndryshimin e Ligjit Kundër Korrupsionit në mënyrë që ligji të kërkojë nga kompanitë të zbatojnë kontrole të brendshme efektive dhe të dekurajojnë praktikat korruptive. Ligji duhet të përmbajë gjithashtu

dispozita të cilat rregullojnë: (1) Veprat që trajtojnë ryshfetin komercial; (2) Sipas ligjit, një kompani duhet të gjykohet fajtorë për një vepër penale të marrjes nëse nuk provon se ka procedurë të përshtatshme për të parandaluar punonjësit e saj nga dhënia e ryshfetit; (3) Ndëshkimet duhet të përfshijnë përjashtimin nga marrja e kontratave publike për kompanitë e përfshirë në korrupsion për periudhën prej 5-10 vitesh dhe gjithashtu të ketë urdhra të konfiskimit; (4) Ligji dhe rregulloret e tjera duhet të deklarojnë qartë se duhet të ekzistojë një mekanizëm për të monitoruar zbatimin e kontratave të prokurimit publik (p.sh. mbi 500,000 euro) sa i përket dorëzimit të sasisë dhe cilësisë së produkteve dhe shërbimeve të specifikuar në dosjen e tenderit.

- Sistemi gjyqësor, prokurorët dhe gjykatat duhet të zhvillojnë kapacitetet e tyre dhe të demonstrojnë angazhim serioz për të rritur rezultatet e tyre në dënime më të ashpra ndaj individëve që janë të angazhuar në praktika korruptive. Ata duhet të përmirësojnë perceptimin dhe të rrisin besimin e bizneseve dhe opinionit të gjerë mbi gjyqësorin, përmes ndëshkimit të korrupsionit në mënyrë efektive.



1. HYRJJE

Instituti Riinvest për Hulumtime Zhvillimore, me mbështetjen e “Programit të Shoqërisë Civile për Shqipërinë dhe Kosovën”, financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA), është duke zbatuar projektin me titull “Kodi dhe koalicioni i bizneseve kundër korrupsionit” me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit të akterëve kryesorë brenda komunitetit të biznesit në Kosovë mbi rëndësinë e zhvillimit të parimeve etike për të reduktuar korrupsionin dhe dhënien e rryshfetit nga bizneset (ana e ofertës së korrupsionit). Një nga rezultatet kyçe të këtij projekti pritet të jetë miratimi i Kodit Kundër Korrupsionit, i nënshkruar nga shoqatat kryesore të biznesit dhe udhëheqësit e biznesit dhe krijimi i një Komiteti Drejtues për të stimuluar dhe ndjekur zbatimin e këtij Kodi.

Vlera e shtuar e këtij projekti është se për herë të parë në Kosovë do të trajtojë fenomenin e korrupsionit nga ana e ofertës, sidomos anën e bizneseve në dhënien e rryshfetit dhe korrupsionit të zyrtarëve publik. Kjo do të kontribuojë në një qasje më komplekse për të adresuar korrupsionin duke përfshirë etikën e biznesit dhe përgjegjësinë sociale të korporatës. Përmes identifikimit të perceptimeve të udhëheqësve të biznesit në lidhje me këtë çështje, përmes eksplorimit të përvojave në vendet e tjera dhe analizës se si legjislacioni po trajton anën e ofertës së korrupsionit dhe nëse ka nevojë për përmirësime të nevojshme, ky projekt është i fokusuar në rritjen e ndërgjegjësimit dhe si rezultat të iniciojë mobilizimin e shoqatave të biznesit dhe udhëheqësve të biznesit kundër nxitjes së praktikave korruptive nga ana e ofertës.

Ky raport hulumtues është përgatitur duke u bazuar në hulumtimet sekondare lidhur me identifikimin e boshllëqeve të legjislacionit në adresimin e çështjes së korrupsionit në anën e ofertës dhe në eksplorimin e përvojave ndërkombëtare. Është përgatitur gjithashtu në bazë të rezultateve të marra nga një anketë me 500 biznese që veprojnë në të gjithë rajonin e Kosovës dhe intervistat e kryera me zyrtarë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Agjencinë Kosovare Kundër Korrupsionit.

Ky raport është i strukturuar si në vijim: seksioni i dytë përfshin një pasqyrë të shkurtër të natyrës dhe pasojat e korrupsionit nga ana e ofertës bazuar në dëshmitë e literaturës; seksioni i tretë mbulon analizën e legjislacionit; seksioni i katërt mbulon përvojat relevante ndërkombëtare; seksioni i pestë prezanton metodologjinë e anketës, gjetjet e hollësishme të studimit, të organizuara në nën seksione që mbulojnë fusha specifike të studimit; së fundi, seksioni i fundit përmban vërejtjet përmblyëse nga analiza dhe gjithashtu paraqet dispozita potenciale kyçe të Kodit të Biznesit kundër Korrupsionit.

Pas prezantimit të raportit, do të zhvillohet Kodi i Bizneseve Kundër Korrupsionit i cili pritet të nënshkruhet nga shoqatat e biznesit dhe udhëheqësit e biznesit. Akterët kryesorë në këtë projekt janë Oda Ekonomike e Kosovës, Klubi i Prodhuesve dhe Rrjeti i Përgjegjësive Sociale të Korporatës. Ekipi pret që gjatë periudhës së implementimit të projektit edhe shoqatat e tjera të biznesit do të angazhohen në zbatimin e aktiviteteve të tij.

Aktivitetet e këtij projekti, posaçërisht nënshkrimi i Kodit të Bizneseve kundër Korrupsionit dhe krijimi i një Komiteti Drejtues që do të përcjell aktivitetet çdo gjashtë muaj, do të kontribuojë në qëndrueshmërinë e përpjekjeve dhe arritjeve. Gjithashtu rritja e vetëdijesimit për nevojën për të luftuar korrupsionin nga ana e ofertës pritet të iniciojë projekte dhe aktivitete në këtë fushë nga shoqatat e biznesit, OJQ-të dhe institucionet qeveritare. Instituti Riinvest synon të përcjell dhe vlerëso-

jë ndikimin e projektit dy vjet pas përfundimit të tij. Pritet që edhe donatorët do të kushtojnë më shumë vëmendje dhe do të mbështesin më shumë aktivitete në këtë fushë të betejës kundër korrupsionit. Është e rëndësishme që projektet e reja të fokusohen në aktivizimin e shoqatave të biznesit në fusha specifike, p.sh. përpunimi i ushqimit, ndërtimi, tregtia etj. Gjithashtu, iniciativat ligjore dhe monitorimi i zbatimit të tyre duhet të kontribuojnë në forcimin e qëndrueshmërisë së projektit.



2. KORRUPSIONI NGA ANA E OFERTËS DHE PASOJAT E TIJ

Niveli i korrupsionit në Kosovë perceptohet si problemi i dytë më i madh në shoqëri (UNDP, 2018) dhe renditet vetëm pas papunësisë. Vlerësimet ndër-kombëtare rendisin Kosovën në mes të listës së 180 vendeve (93), me Indeks të Perceptimit të Korrupsionit (CPI) prej 37, mjaft të ngjashëm me vendet e tjera të rajonit, të ngjashëm me Serbinë, Shqipërinë, Bosnjën dhe Maqedoninë me CPI 36-39 (Transparency International, 2019). Shumica e vendeve në Ballkanin Perëndimor, përveç Maqedonisë, kanë përkeqësuar CPI e tyre. Kosova përkeqësoi pozicionin e saj për dy renditje. Gjykatat, doganat, dhe qeveria perceptohen me mbizotërimin më të madh të rasteve të rënda të korrupsionit (UNDP, 2018).

Edhe pse gjatë tre viteve të fundit, në Kosovë është vërejtur një përmirësim modest në aspektin e CPI duke u ngritur nga pozita e 33 (2015) në 37 (2019), ende, siç edhe tregon sondazhi i Pulsit Publik të UNDP-së (2018), niveli i korrupsionit perceptohet si një problem i rëndë dhe po pengon zhvillimet në forcimin e sundimit të ligjit, në përmirësimin e klimës së biznesit dhe atraktivitetin për të investuar në vend.

Korniza ligjore dhe organet institucionale janë zhvilluar për të parandaluar dhe gjithashtu për të ndëshkuar korrupsionin. Shoqëria civile dhe opinioni publik janë të shqetësuar dhe po debatojnë për këtë çështje. Por nga ana tjetër, sistemi gjyqësor nuk është parë si i suksesshëm në adresimin e rasteve kundër korrupsionit dhe institucionet kryesore qeveritare ende nuk e trajtojnë këtë çështje siç duhet. Mungesa e vullnetit politik për të luftuar seriozisht

korrupsionin, përveç kapaciteteve joadekuade për zbatimin e sundimit të ligjit, shihen si një problem kyç. Presioni i opinionit, mediave dhe shoqërisë civile ende nuk ka arritur masën kritike për të rritur intolerancën e shoqërisë mbi praktikën korruptive. Në përgjithësi, aktivitetet dhe politikat për luftimin e korrupsionit deri më tani kanë shënuar arritje modeste.

Pothuajse çdo shtet ndalon përdorimin e praktikave korruptive për të siguruar kontrata qeveritare dhe përpjekje të konsiderueshme janë bërë për të rregulluar sjelljen e zyrtarëve qeveritarë të lidhur me procesin e prokurimit. Pavarësisht nga kuadri ligjor në fuqi dhe infrastrukturës ekzistuese për të luftuar korrupsionin, ekziston edhe presioni i segmenteve në shoqëri, sidomos nga sektori privat për të fituar kontrata fitimprurëse që vijnë nga dëshira për fitime shtesë. Dhe kjo kufizon rreptësisht rezultatet e aktiviteteve kundër korrupsionit (Sikka & Lehman, 2015). Korporatat angazhohen në praktika korruptive për tri arsye kryesore: të ruajnë çmime më të larta, të mbajnë një treg për produktet e vjetërsuara dhe të mbeten në fushën konkurruese, veçanërisht nëse shitjet e mëtejshme mund të sigurohen në një datë të mëvonshme (Moody-Stuart, 1997). Në mungesë të pengesave morale efektive, çdo marrëveshje konsiderohet e pranueshme për sa kohë që është e dobishme. Korporatat duhet të pranojnë se ato janë krijuar për t'i shërbyer shoqërisë dhe duhet të kenë përgjegjësi ligjore më të gjera sesa thjesht ndjekja e fitimeve private. Pa këtë, programet e mbikëqyrjes dhe të kontrolleve të brendshme mund të arrijnë sukses marginal, por nuk kanë gjasa të bëjnë një ndryshim të rëndësishëm në reduktimin

e praktikave korruptive. Përdorimi i çmimeve të tregut si pikë referimi për zbulimin e çmimeve artificiale dhe të fryra është një nga mundësitë për një marrëveshje për të luftuar korrupsionin nga ana e ofertës.

Fokusi i akterëve të ndryshëm në Kosovë në adresimin e problemit të korrupsionit deri më tani ka qenë në anën e kërkesës – prokurimit, zyrtarët e qeverive lokale dhe qendrore, ndërmarrjet publike, gjykatat, shëndetësia dhe sektori i arsimit. Ato janë parë si një akter kyç që gjeneron korrupsion. Kjo është e vërtetë, por vetëm në masë të caktuar. Është e qartë se në angazhimet e përgjithshme ndaj korrupsionit në Kosovë, ana e ofertës së korrupsionit është lënë pas dore, sidomos ana e ofertës nga sektori i biznesit, respektivisht ryshfetet që jepen nga kompanitë tek zyrtarët qeveritarë dhe menaxherët e NP. Kjo është një situatë kur një numër i caktuar i bizneseve orkestrojnë korrupsionin për të fituar avantazh konkurrues dhe kthime të jashtëzakonshme. Ato sigurojnë përfitime për veten e tyre në krah të shumicës dërrmuese të bizneseve. Bizneset e tjera dhe shoqëria në tërësi janë viktima.

Konkurrenca e padrejtë është konsideruar për vite me radhë nga bizneset si një barrierë e madhe për të bërë biznes nga një listë me 14 barrierë (anketat vjetore të NVM-ve Riinvest që nga viti 2001). Konkurrenca e padrejtë vjen kryesisht nga korrupsioni dhe ryshfeti gjatë prokurimit dhe në masë të caktuar nga sektori informal. Kompanitë e dënojnë sjelljen e akterëve në anën e kërkesës së korrupsionit, por ata kanë lënë pas dore trajtimin e elementeve korruptive dhe sjelljet e sektorit të biznesit dhe organizatave të biznesit që sillen në mënyrë jo etike dhe janë “kreativ” për të gjetur një mënyrë për të shmangur konkurrencën e ndershme. Kështu, është koha që shoqatat e biznesit dhe bizneset të trajtojnë këtë çështje dhe të mobilizojnë komunitetin e tyre për të eliminuar ose të paktën të ulin sjelljen jo-etike në biznes. Kjo është një çështje që është adresuar në shumë vende dhe ekziston një dëshmi e madhe e literaturës dhe mësimet që duhen mësuar. Në Kosovë mungojnë aktivitetet në këtë sektor.

Si rezultat i kësaj situatë, Instituti Riinvest konsideron me rëndësi kyçe për të iniciuar aktivitete në bashkëpunim me shoqatat kryesore të biznesit dhe

udhëheqësit e bizneseve për të hedhur dritë mbi këtë fenomen duke synuar gjithashtu zhvillimin e një koalicioni të biznesit kundër korrupsionit. Është e qartë se përveç kapaciteteve institucionale dhe gatishmërisë politike për të luftuar korrupsionin ekziston edhe një segment tjetër plotësues për të arritur më shumë rezultate. Është një krijim i masës kritike të vetëdijes në një shoqëri që dënon korrupsionin dhe angazhohet në mënyrë aktive për të identifikuar dhe ndëshkuar korrupsionin.

Situata aktuale në Kosovë karakterizohet kryesisht me kritika nga shoqëria civile në medie, por në anën tjetër ka pjesë të shoqërisë kosovare, ndër të tjera komuniteti i biznesit, që kanë marrë një qëndrim pasiv ndaj kësaj çështjeje. Edhe më keq, disa segmente të shoqërisë në pasivitetin e tyre pasqyrojnë një situatë kur korrupsioni merret si një fakt me të cilin duhet jetuar. Ekziston një nevojë përfundimtare që akterët kyç në shoqëri të krijojnë një masë kritike të intolerancës aktive kundër korrupsionit dhe të ndryshojnë këto qëndrime. Klientelizmi dhe lidhjet në mes të grupeve politike dhe të interesit të biznesit që orkestrojnë korrupsionin në prokurimin publik janë ndër elementët kyçe të shtetit të kapur. Masa kritike e ndërgjegjësimit dhe veprimit të shoqërisë kundër korrupsionit duhet të komprometojë dhe të mposhtë këto lidhje, ndër të tjera, por pa u kufizuar në, nëpërmjet zgjedhjeve.

Si e tillë, është më se e domosdoshme që të ndërgjegjësohen qytetarët dhe bizneset për kostot e mëdha të korrupsionit në proceset demokratike, në pengimin e investimeve dhe në ngadalësimin e zhvillimit ekonomik. Korrupsioni pengon rritjen ekonomike dhe ndikon në operacionet e biznesit, punësimin dhe investimet. Ai gjithashtu redukton të ardhurat nga tatimet dhe efektivitetin e programeve të ndryshme të asistencës financiare. Shoqëria më e gjerë është e ndikuar nga një shkallë e lartë e korrupsionit në aspektin e uljes së besimit në ligj dhe sundimit të ligjit, cilësinë e arsimit dhe rrjedhimisht në cilësinë e jetës, për qasje në infrastrukturë dhe kujdes shëndetësor (Sumah, 2018). Korrupsioni ndikon negativisht ndarjen optimale të kapitalit nëpërmjet kushteve të çregulluara të tregut. Kjo është për shkak se korrupsioni çon në përzgjedhjen e kontraktuesve me lidhje dhe ata që kanë më shumë gjasa të japin ryshfet në vend të atyre që ofrojnë produktin më të mirë (Instituti Australian,

2018). Një ndikim negativ që është treguar është ngadalësimi i ritmit të rritjes ekonomike. Në disa studime empirike rezultatet kanë treguar se ritmi është ngadalësuar për rreth 50% (Wei, 2001). Në një përfundim të ngjashëm kanë dalë edhe studimet e porositura nga DIFID (2015) dhe GTZ (2008), përmes provave të studimeve empirike dhe hulumtimeve në pjesë të ndryshme të botës. “Një rënie në incidencën e korrupsionit nga niveli i gjetur në Azerbajxhan (i lartë) ndaj atij që mbizotëron në Estoni (mjaft i ulët) lidhet me rritjen e probabilitetit të investimeve të huaja nga 9-14%” (GTZ 2008). Ky studim paraqet argumente të forta se niveli i korrupsionit lidhet negativisht me investimet në arsim, shëndetësi dhe mjedis.

Në përgjithësi, korrupsioni krijon një sërë shtrembërimesh në vëllimin dhe destinacionin e investimeve publike. Dërgon në evazionin fiskal, dëmton imazhin e vendit dhe besueshmërinë dhe ul normat e rritjes, stimulon papunësinë dhe pabarazinë, respektivisht varfërinë. Sipas një studimi të DFID dhe raportit të OECD (2013) korrupsioni rrit koston e të bërit biznesit mesatarisht me 10% në nivel të firmës. Por në disa pjesë të botës, përqindja që firmat pritët t’u japin zyrtarëve janë shumë më të larta. Në një periudhë afatgjatë, korrupsioni mund të pengojë motivimin dhe interesin e bizneseve

për të rritur kapacitetet e tyre konkurruese, inovacionin dhe produktivitetin, pasi që ai dëmtojnë konkurrencën e ndershme dhe bizneset nuk janë në presion për të qenë më konkurruese pasi disa prej tyre rrisin shitjet përmes rryshfetit. Për më tepër, studimi i Universitetit DePaul në Çikago i 300 kompanive të mëdha tregoi se ato kompani “që bënin një angazhim eksplisit për të ndjekur standardet etike, siguronin më shumë se dyfishin e vlerave ndaj aksionarëve se kompanitë që nuk bënin angazhim” (CSIS - SFP, 2005).

Duke pasur parasysh të gjithë këto, duhet të ketë shumë më tepër aktivizim të shoqërisë civile dhe përpjekje të organizuara të akterëve të ndryshëm në shoqëri si media dhe shoqata të biznesit që do të edukonin dhe rrisin ndërgjegjësimin mbi koston e përgjithshme të korrupsionit për shoqërinë. Dhe se kjo nuk është çështje vetëm për prokurorët, gjykatat, por po aq edhe për qytetarët, për NVM-të, për deputetët e parlamentit, pasi të gjithë i paguajnë koston e korrupsionit nëpërmjet më pak vendeve të reja të punës, më pak investime në arsim dhe shëndet, më shumë varfëri dhe në biznese më pak konkurruese. Një përpjekje e tillë duhet të rezultojë në “zero” tolerancë ndaj korrupsionit dhe të demonstronit edhe në zgjedhjet lokale dhe kombëtare.



3. ASPEKTET DHE ZBRAZËTIRAT LIGJORE

Në aspektin teknik, Kosova ka ndërtuar një kornizë ligjore solide, të krahasueshme me vendet tjera të rajonit dhe vendet tjera demokratike për luftimin e korrupsionit dhe parandalimin e korrupsionit. Sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës, luftimi dhe parandalimi i korrupsionit përkufizohet tek personat zyrtarë dhe detyrat zyrtare, dhe bazohet me masa ndëshkuese. Kodi Penal i Kosovës, marrjen dhe dhënien e ryshfetit, apo të dhuratave apo favoreve tjera nga personat fizik, i sanksionon si vepra të rënda penale. Në kuadër të Kapitullit XXXIV-Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, nenet 414-430, të Kodit Penal të Kosovës (NR. 06/L-074, 14 janar 2019) në fuqi, janë sanksionuar një mori veprimesh antiligjore të zyrtarëve si vepra penale, varësisht prej peshës, të dënueshme nga dënimi me gjobë, për vepra më të lehta penale, deri te dënimi me burg në kohëzgjatje nga 6 muaj deri në 12 vjet burg, për vepra të rënda penale, duke përfshirë këtu edhe konfiskimin e pasurisë së përfutur kundërligjshëm. Gjithashtu, në këto nene sanksionohet edhe dhënia/premtimi i dhënies së ryshfetit apo favoreve tjera një personi zyrtar në këmbim të ndonjë veprimi apo mosveprimi në kundërshtim të detyrës zyrtare, është e dënueshme, duke filluar nga dënimi me gjobë deri te dënimi me burg deri në 5 vjet.

Përveç Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në kuadër të Kornizës ligjore për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit përfshihen edhe Ligji Nr. 2004/34 kundër korrupsionit dhe Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit Nr. 65/05. Ligji Kundër Korrupsionit në fuqi është i aprovuar nga institucionet e përkohshme, në vitin 2004.

Sidoqoftë, edhe pse infrastruktura ligjore për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit në Kosovës, mund të konsiderohet solide, ajo nuk është e mjaftueshme për parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie tejet të dëmshme për zhvillimin ekonomiko-social dhe demokratik të shoqërisë kosovare. Nga ana tjetër, mungesa e gatishmërisë dhe vullnetit politik për zbulimin dhe adresimin e rasteve të korrupsionit, pastaj numër tejet modest i rasteve të gjykuara me vendime përfundimtare të gjykatave, dënime modeste në raport me peshën e veprave, lëndë të parashkruara, etj., e rëndojnë edhe më shumë klimën biznesore, ardhjen e investimeve të jashtme direkte, dhe po i zbehin përpjekjet për fuqizimin e ligjit dhe llogaridhënies.

Dispozitat e Kodit Penal të Kosovës në lidhje me veprat penale të korrupsionit janë aplikuar kryesisht ndaj zyrtarëve publikë, që deri diku është e logjikshme pasi që kjo kategori janë të ekspozuar më së shumti dhe joshjet për të hyrë në vepra penale të korrupsionit dhe të aferave tjera korruptive. Nga ana tjetër, zyrtarët e korporatave, kompanive, shoqatave të biznesit dhe nga komuniteti i biznesit në përgjithësi janë më pak të ekspozuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dispozitave ligjore për veprimet e tyre eventuale korruptive, përveçse në rastet e ofrimit apo dhënies së ryshfetit në procedurat e tenderëve publikë apo për ndonjë favor tjetër për kompanitë apo bizneset e tyre.

Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Nr.06/L-011) në dispozitat e tij ndalon veprimet e zyrtarit publik që në ndonjë mënyrë bien në kundërshtim me parimet

dhe etiken e zyrtarit publik. Detyrimi për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit, Neni 8 i këtij ligji, obligon personin i cili me marrjen e detyrës së zyrtarit publik dhe gjatë ushtrimit të saj, ai ka për detyrë që të parandalojë dhe të zgjedh mënyrën më efektive të mundshme, që çdo situatë të konfliktit ndërmjet interesave të tij publike dhe private. Funkzioni i kësaj dispozite ligjore është që të parandalojë që zyrtari publik, duke qenë në konflikt interesi me persona apo subjekte të caktuara, të jetë i ekspozuar para situatave të cilat favorizojnë atë për keqpërdorimin e pozitës së tij zyrtare, duke u joshur për korrupsion, marrje të rryshfetit apo favoreve tjera në dëm të personave apo bizneseve private.

Me Kodin Penal të Kosovës (KPK) nuk është adresuar qartë që personat përgjegjës të organizatës biznese të sanksionohen në rastet kur pranojnë dhurata apo përfitime tjera në kundërshtim me ligjin me qëllim të dëmtimit të organizatës së tyre gjatë arritjes së ndonjë marrëveshjes biznese. Kjo nuk do të thotë se në rastet e këtilla, personat përgjegjës në organizata biznese të mos japin llogari për veprimet e tyre korruptive, pasi që me dispozitat e KPK-së, rastet e tilla mund të përfshihen në kuadër të atyre dispozitave me të cilat sanksionohen personat zyrtar, edhe pse nuk specifikohet nëse është fjala për persona zyrtarë publikë apo privat.

Në përgjithësi nga analiza e kornizës ligjore të Kosovës del se ka nevojë që dispozitat e ndërlidhura me anën e ofertës në korrupsion kanë nevojë për saktësim, përplotësim dhe ashpërsim të sanksioneve. Kështu për shembull Kodi Penal i Sllovenisë (KPS), i adreson në mënyrë më cilësore dhe gjithëpërfshirëse veprat penale si rezultat e aktiviteteve korruptive në dhe gjatë aktiviteteve biznese në organizata biznese (Shih nenet 244-249). Aty precizohet se kush do që gjatë aktivitetit të tij biznesor kërkon apo pranon për veten e tij apo për dikën tjetër ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër në kundërshtim me ligjin me qëllim që me veprimet e tij të dëmtojë organizatën e tij apo ndonjë palë tjetër që organizata e tij apo ndonjë person tjetër me rastin e arritjes së ndonjë marrëveshje biznese, do të dënohet me burg prej 6 muaj deri në pesë vjet (Neni 247 i Kodit Penal të Sllovenisë).

Kodi penal i Shqipërisë (2016) e sanksionon korrupsionin aktiv në sektorin privat përmes Nenit 164/a dhe korrupsionin pasiv (Neni 164/b). Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, personit që ushtron funksion drejtues në shoqëri tregtare ose punon në çdo pozicion në sektorin privat, për të kryer ose mos kryer një veprim në kundërshtim me detyrën ose funksionin e tij, dënohet me burgim nga tre muaj deri në tre vjet (Neni 164/a).

Korrupsioni pasiv në sektorin parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënim-it me burgim. Kërkimi a marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt a i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi, që vjen nga përfitimi i parregullt, nga personi që ushtron funksion drejtues ose punon në çdo pozicion në sektorin privat, për të kryer ose mos kryer një veprim në kundërshtim me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet (Neni 164/b).

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, personit që ushtron funksionin publik, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën ose funksionin e tij, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet. Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim nga një deri në pesë vjet.

Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve të korrupsionit i cili vlerësohet se krijon mbrojtje dhe ambient më të sigurt për informatorët e rasteve të korrupsionit duke përfshirë edhe sektorin privat, duke inkurajuar edhe bizneset private për sinjalizimin e rasteve të korrupsionit në sektorin e tyre. Një sinjalizues ose personi i afërt me të i cili mund të ketë pasoja në lidhje me sinjalizimin ka të drejtën e mbrojtjes gjyqësore. Ligji ofron mbrojtje dhe anonimitet të plotë për sinjalizuesit, gjegjësisht raportuesit e rasteve të korrupsionit në sektorin privat, duke përfshirë

edhe mbrojtjen nga ndëshkimet, hakmarrjet apo shantazhet nga eproret e tyre dhe punëdhënësit.

Përveç sistemit të drejtësisë dhe policisë, edhe Agjencia Kundër Korrupsionit e Kosovës (NR. 03/L-159) si organ i pavarur dhe i specializuar, merret me zbatimin e politikave shtetërore për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit në Kosovë. Sipas vlerësimeve të AKK, bizneset e raportojnë korrupsionin kur u cenohet e drejta e tyre, ndërsa në raste të tjera ato e heshtin. Është për tu nënvizuar se akoma nuk praktikohet lista e zezë për bizneset që përfshihen në afëra korruptive.

Në AKK nuk kanë ndonjë metodologji për trajtimin e evidencave statistikore të kërkesave dhe rasteve të korrupsionit sipas sektorëve të caktuar, gjithashtu ato që konsiderohet si oferta nga përfaqësuesit e bizneseve. AKK është e përqendruar kryesisht në parandalimin dhe inicimin e procedurave ligjore të rasteve të korrupsionit të zyrtarëve publik. Në Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) të dhënat janë në proces të digjitalizimit dhe besohet se do të jenë të gatshme deri në fund të vitit 2019. Mirëpo, KGJK nuk ka të dhëna të sakta për numrin e bizneseve të përfshira në raste gjyqësore për arsye se nuk bëhet ndarja në mes të individëve dhe bizneseve të cilët kanë kryer veprën e përfshirjes në korrupsion.

Në Itali, më shumë se në ndjekjen dhe parandalimin e korrupsionit në zanafillën e tij, rëndësi më të madhe i kushtojnë monitorimit rigoroz të zbatimit të kushteve të kontratave të operatorëve ekonomik me organizatat qeveritare, gjegjësisht me sektorin publik në përgjithësi. Monitorimi në mënyrë rigoroze i zbatimit të kontratave që vijnë nga prokurimi publik mund të zvogëlojë nxitjen për ryshfet. Në rastet kur kontrata i jepet ofertuesit i cili ofron çmime më të ulëta, që në kushte të caktuara të tregut mjaft shpesh nuk siguron ndonjë marzhë pozitive, shpjegimi i vetëm i arsyeve prapa kësaj mund të jetë që gjatë zbatimit të kontratës, operatori nuk do të ofrojë standardet e kërkuara të cilësisë me specifikimet ose do të zvogëlojnë sasinë e dorëzuar. Monitorimi, kontrolli dhe auditimi i implementimit të kontratave nuk ka qenë praktikë në Kosovë. Kjo duhet të trajtohet me ligj ose rregullore më së paku për kontratat mbi një vlerë të caktuar (p.sh. 500,000 euro).

Ani pse korniza ligjore kundër korrupsionit në Kosovë konsiderohet se ka krijuar parakushtet bazike për lufte kundër korrupsionit ajo ka disa mangësi evidente dhe ka nevojë të përmirësohet. Përmirësimet do të duhej të shkonin në drejtim të krijimit të një sistemi të monitorimit sidomos tek zbatimi i kontratave nga prokurimi publik. Gjithashtu do të duhej ashpërsuar sanksionet për organizatat biznesore dhe udhëheqësit e tyre në rast të përfshirjes në korrupsion. Sanksionet përveç dënimeve materiale do të mund të përfshinin edhe përjashtimin e tyre nga mundësia për pjesëmarrje në tenderë të lidhur me prokurim publik (5-10) vite si dhe vënien e atyre bizneseve në një lloj liste të zezë. Gjithashtu sanksionet do të duhej të përfshinin edhe personat përgjegjës nga menaxhmenti.

3.1 KORNIZA LIGJORE NË VENDET E RAJONIT

Në Serbi, firmat mund të lirohen nga fajësia nëse ato detektojnë dhe po ashtu raportojnë veprën penale para se të kuptojnë që ajo çështje është iniciuar, apo kur eliminon pasojat e shkaktuara në baza vullnetare dhe pa vonesa (GAN, 2017). Legjislacioni po ashtu përfshin edhe informatorët të njohur si sinjalizuesit. Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve rregullon procedurat, të drejtat e sinjalizuesve, obligimet e autoriteteve shtetërore dhe organizatave tjera në lidhje me raportimet. Bizneset janë të obliguara sipas ligjit që të implementojnë masa të ndryshme për të lehtësuar aktivitetin e sinjalizuesve (GAN, 2017). Serbia është pjesë Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC).

Në Maqedoni, Ligji për Parandalimin e Korrupsionit si dhe Kodi Penal, e cilëson si vepër penale korrupsionin pasiv dhe aktiv, zhvatjen, korruptimin e zyrtarëve publik të huaj, tentimin për të korruptuar, keqpërdorimin e pozitës duke abuzuar me ndikimin si dhe shpëlarjen e parave. Dispozitat kundër korrupsionit aplikohen tek të gjithë personat fizik qoftë në sektorin publik dhe në atë privat dhe bizneset mbahen penalisht përgjegjëse për aktivitetet korruptive të kryera nga përfaqësuesit e tyre. Pagesat për lehtësim apo përshpejtim të punëve janë po ashtu të ndaluara, dhe gjithashtu dhuratat mund të konsiderohen si të jashtëligjshme varësisht nga vlera e tyre, qëllimi apo përfitimi (Gan, 2018). Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve konsiderohet nga ligjet më të ashpra në rajon (SECWP, 2017). Ky ligj

siguron mbrojtjen e punonjësve në sektorin privat apo publik për raportimet e shkeljeve në mënyrë konfidenciale si dhe i mbron ata nga ndjekja penale dhe llojet e tjera të përgjegjesisë (SECWP, 2017). Maqedonia ka ratifikuar Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC) (Gan, 2018).

Në Mal të Zi, Kodi Penal aplikohet për të gjithë personat fizik në sektorin publik apo privat dhe gjithashtu e konsideron si jo të ligjshme çdo lloj forme të mitos qoftë aktive apo pasive, abuzimin me pozitën zyrtare, mashtrimin, ndikimin, dhe abuzimin me autoritetin në çështje biznesore. Ligji për Përgjegjësinë Penale të Personave Juridik i bën bizneset përgjegjëse për veprat penale të kryera nga përfaqësuesit e tyre (GAN, 2015). Mali i Zi po ashtu ka ratifikuar Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC).

Në Kroaci, Kodi Penal aplikohet për investitorët vendor dhe të huaj dhe mbulon çështje si ndikimi, abuzimi me pozitën zyrtare, pjesëmarrja aktive dhe pasive në mito, përvetësimi i pronës publike apo private, dhe pastrimin e parave. Dhënia e mitos në sektorin privat është po ashtu e dënueshme (GAN, 2017). Dhënia apo marrja e mitos në aktivitetet biznesore është e jashtëligjshme në Kroaci. Bizneset si entitete ligjore mund të mbahen përgjegjëse për veprime korruptive dhe dënimet mund të përfshijnë konfiskimin e përfitimeve të marra (CMS, 2016). Nuk ka ndonjë ligj specifik që i mbron sinjalizuesit. Sa i përket konventave ndërkombëtare, ngjashëm si vendet tjera më lartë edhe Kroacia ka nënshkruar Konventën e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit (UNCAC). Sidoqoftë, Kroacia nuk e ka të nënshkruar Konventën kundër Ryshfetit të OECD-së (GAN, 2017).



4. PRAKTIKAT RELEVANTE NDËRKOMBËTARE

Korrupsioni nga ana e ofertës është një çështje që është trajtuar dhe adresuar në shumë vende dhe për të cilën ka literaturë të mjaftueshme dhe gjithashtu mësim për t'u mësuar. Shembulli më i njohur është Mbretëria e Bashkuar (UK). Ky vend ka ndërtuar një kornizë ligjore e cila i detyron bizneset të implementojnë kontrolle të brendshme efektive dhe të dekurajojnë praktikën korruptive. Këtu përfshihen ligje si Ligji për Mashttrim i vitit 2006, ai Bizneseve 2006, si dhe Ligji për Miton 2010 (Sikka & Lehman, 2015). Ligji që trajton ryshfetin konsiderohet si një nga ligjet më të fuqishme në Botë kundër korrupsionit. Ky ligj përfshin shkeljet që kanë të bëjnë me dhënien apo marrjen e mitos në aktivitetet biznesore. Sipas këtij ligji, një kompani shpallet fajtorë për shkeljen që ka të bëjë me ryshfetin nëse ajo dështon të dëshmojë se ka pasur procedurat adekuatë të parapara për parandalimin e punonjësve të saj të përfshihen në afëra të tilla korruptive. Dënimet përfshin ndalimin për të fituar kontrata publike dhe urdhër për konfiskimin e pasurisë së jashtëligjshme. Po ky ligj ofron udhëzime specifike për krijimin dhe operacionalizimin e një sistemi të menaxhimit kundër ryshfetit. Ky ligj specifikon edhe standardet si ISO 37001 të cilat shërben si një udhëzues për krijimin, implementimin, mirëmbajtjen, rishikimin dhe përmirësimin a sistemit kundër ryshfetit. Është vendi i parë nga të gjitha vendet e G20 që ka krijuar një regjistër publik të pronësisë për kompanitë vendore si dhe vendi i parë nga lista e vendeve të G7 që ka bërë vlerësimin e transparencës fiskale të FMN-së (HM Government, 2017).

Në Korenë Jugore, Ligji për Kërkesa të Papërshtatshme dhe Ryshfetin është miratuar në fund të vitit 2016 me qëllim të eliminimit të korrupsionit kronik. Sipas këtij Ligji, nëse një punonjës kërkon ndonjë favor apo ofron para apo gjëra të tjera me vlerë për punën e tij/saj, jo vetëm punonjësi mirëpo edhe punëdhënësi në këtë rast do të përballet me sanksione. Sidoqoftë, në rastet ku punëdhënësi nuk ka qenë neglizhent dhe i ka kushtuar vëmendje dhe ka marrë masa për parandalimin e shkeljeve, atëherë mund të lirohet nga sanksionet. Sipas këtij ligji, punëdhënësit duhet të bëjnë përpjekje të parandalojnë korrupsionin. Në të kundërtën, ata rrezikojnë të ballafaqohen me dënime (Komisioni kundër Korrupsionit dhe të Drejtat Civile, 2016). Për më tepër, Koreja Jugore gjithashtu ka miratuar Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve për Interesin Publik. Sipas këtij ligji nëse një punonjës zbulon detajet e raportit përfshirë të dhënat personale të sinjalizuesve, u krijon disavantazh sinjalizuesve, apo pengon ose anulon një proces informimi me interes publik, jo vetëm punonjësi do të ballafaqohet me masa ndëshkuese por edhe punëdhënësi në këtë rast do të gjobitet (Komisioni kundër Korrupsionit dhe të Drejtat Civile, 2016). Sidoqoftë, në raste të tilla, punëdhënësi mund të lirohet nga sanksionet nëse ai apo ajo ka qenë i vëmendshëm në mbikëqyrjen e personelit në parandalimin e shkeljeve të tilla gjatë punës.

Si të tilla, aktivitetet e korporatave kundër korrupsionit nuk janë çështje zgjedhje, por një kërkesë (Komisioni kundër Korrupsionit dhe të Drejtat Civile, 2016). Përgjegjësitë ligjore janë vendosur në korporata për të mbikëqyrur në mënyrë aktive dhe

për të parandaluar çdo shkelje të punonjësve të tyre. Masat e reja kanë rezultuar në ndryshimin e kulturës së korporatave në Korenë Jugore duke rezultuar në rritjen e numrit të korporatave që nuk tolerojnë shkelje në aktivitetet biznesore, pavarësisht shkallës së veprave penale, dhe ato janë në dijeni se aktivitetet e ligjshme dhe etike të biznesit në fund të fundit të çojnë në përfitime më të mëdha (Anti-Corruption & Civil Rights Commission, 2016).

Shtetet e Bashkuara (SHBA) përmes Aktit të Praktikave të Jashtme të Korrupsionit 1977, zbatojnë një program të standardizuar të etikës për qeverinë, organizatat e anëtarësuar, korporatat, shkollat dhe organizatat e tjera. Se sa efektiv është zbatimi i programeve kundër korrupsionit që një kompani ka krijuar dhe operacionalizuar është një nga elementet kryesore që konsiderohet për ndjekjen dhe dënimin e punëdhënësve (Anti-Corruption & Civil Rights Commission, 2016).

Një shembull tjetër është prezantuar nga Lituania, një vend anëtar i OECD, ku vendi ka miratuar Programin Kombëtar Kundër Korrupsionit të Republikës së Lituanisë për 2015-2025 (Vilnius, 2015). Si rezultat, vendi ka hartuar Planin e Veprimit Ndërinstitucional 2015-2019 për zbatimin e programit. Si pjesë e masës zbatuese, është hartuar Doracaku kundër Korrupsionit për Biznese. Qëllimi i doracakut është të ndihmojë në krijimin e një mjedisi të biznesit që është i lirë nga korrupsioni.

Në Bosnjë, si përgjigje ndaj korrupsionit në prokurimin publik, në vitin 2009, menaxherët dhe pronarët e kompanive private që marrin pjesë si ofertues në prokurimin publik formuan Asociacionin e qytetarëve për Tender. Shoqata është krijuar si OJQ dhe është e përkushtuar në promovimin e bashkëpunimit me të gjithë personat juridikë në sektorin publik dhe privat, në forcimin e rolit dhe kapacitetit të shoqërisë civile në luftën kundër praktikave korruptive në prokurimin publik (Regional Academy of the United Nations, n.d.).

Një shembull tjetër i mirë i një vendi që ka bërë një punë të mirë në luftën kundër korrupsionit është Gjeorgjia. Ky vend tashmë dënon pjesëmarrjen aktive dhe pasive në mito, gjithashtu ka fuqizuar legjislacionin lidhur me pastrimin e parave, ka një kod të përgjithshëm etik për nëpunësit civilë, dhe

dispozitat për deklarimin e pasurisë dhe mbrojtjen e informatorëve lidhur me zyrtarët publik (Transparency International, 2015). Qeveria gjithashtu ka hartuar Strategjinë Kundër Korrupsionit dhe Planin e saj të Veprimit, e cili përfshin një seksion të integritetit të biznesit që është përgatitur në bashkëpunim me sektorin privat (OECD, 2016). Strategjia kundër Korrupsionit gjithashtu përfshin një seksion mbi parandalimin e korrupsionit në sektorin privat. Strategjia, mes tjerash, parashikon ngritjen e vetëdijes publike për çështjet e integritetit të biznesit.

Bashkimi Evropian në vitin 2003 ka marrë një vendim kornizë të Këshillit 2003/568 /JHA, i cili kërkon që shtetet anëtare të vendosin ndëshkime penale efektive, proporcionale dhe bindëse për ryshfetin aktiv dhe pasiv. Së bashku me këto linja, Franca në Kodin Penal përcakton shkeljet e lidhura me korrupsionin, siç janë ryshfeti aktiv dhe pasiv i zyrtarëve publikë vendas dhe të huaj, ndikimi, zhvatja nga një zyrtar publik dhe përvetësimi, si dhe ryshfeti në sektorin privat. Ai gjithashtu mbron sinjalizuesit me anë të futjes së një dispozite specifike në Kodin e Punës (European Parliamentary Research Service, 2017). Më tej, Ligji i vitit 2016 mbi transparencën, luftën kundër korrupsionit dhe modernizimin e ekonomisë kërkon që kompanitë e mëdha të krijojnë kanale të brendshme për raportimin e sjelljeve të pahijshme si pjesë e masave të tjera për zbulimin dhe parandalimin e korrupsionit të detyrueshëm, duke përfshirë hartimin e riskut të korrupsionit dhe mekanizmat e brendshëm parandalues. si kode të sjelljes (European Parliamentary Research Service, 2017). Në Gjermani, Ligji kundër Korrupsionit është ndryshuar në vitin 2015 dhe ndryshimet kanë lejuar zgjerimin e zbatimit të ligjeve që lidhen me korrupsionin për të përfshirë rastet në të cilat praktikant korruptive çojnë në shkelje të detyrave të punonjësve (European Parliamentary Research Service, 2017).

Organizatat ndërkombëtare si Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), Banka Botërore dhe Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC) gjithashtu kanë kështu një vëmendje të mirë ndaj korrupsionit nga ana e ofertës. Të tre organizatat kanë hartuar së bashku një doracak për të ndihmuar qeveritë e vendeve të G20 që të praktikojnë zbatimin e Planit të Veprimit

kundër Korrupsionit G20 që u përqendrua në Luftën kundër Korrupsionit, Promovimin e Integritetit të Tregut dhe Mbështetjen e një Ambienti të Pastër të Biznesit. Ky plan njihet si rol integral të sektorit privat në luftën kundër korrupsionit dhe bën thirrje për partneritet më të madh publiko-privat në këtë përpjekje. Doracaku është zhvilluar me qëllim që të shërbejë si një mjet i dobishëm dhe praktik për kompanitë që kërkojnë të gjejnë këshilla (OECD & UNODC & World Bank, 2013).

OECD gjithashtu ka miratuar një konventë ndërkombëtare mbi Luftimin e Korrupsionit të Zyrtarëve të Jashtëm në Transaksionet Ndërkombëtare të Biznesit. Duke nënshkruar transaksionin, anëtarëve të vendeve të OECD-së u është kërkuar të miratojnë legjislacionin që mundëson forcimin e ndëshkimeve dhe gjobave për praktikën korruptive. Konventa e OECD-së për Luftimin e Korrupsionit të Zyrtarëve të Jashtëm Publik në Transaksionet Ndërkombëtare të Biznesit, ratifikimi të cilës është një nga parakushtet për anëtarësim në OECD, përcakton zbatimin e përgjegjësisë së gjerë të personave juridik për korrupsionin e zyrtarëve të huaj publikë, ndihmë ligjore reciproke efektive në hetimet penale të sjellura nga një palë në lidhje me veprat penale (OECD & UNODC & World Bank, 2013). Konventa është përfshirë në ligjet e 37 shteteve që kanë nënshkruar Konventën (30 anëtarët e OECD, plus Argjentina, Brazili, Bullgaria, Kili, Estonia, Sllovenia dhe Afrika e Jugut). Vendet që kanë nënshkruar Konventën bien dakord që korrupsionin e zyrtarëve e huaj publikë në transaksionet ndërkombëtare të biznesit ta cilësojnë si një vepër penale. Për të siguruar zbatimin efektiv të Konventës dhe Rekomandimeve

korrigjuar, vendet nënshkruese kanë miratuar një proces monitorimi të vazhdueshëm bazuar në parimet e shqyrtimit nga shtetet tjera anëtare të OECD-së (OECD, 2008). Dispozitat e Konventës kundër Korrupsionit të OECD-së në anën “ e ofertës” së rryshfetit janë shumë të detajuara dhe standardet e saj janë të vështira.

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC) ka hyrë në fuqi në vitin 2005. Shtetet anëtare kanë marrë pjesë në Mekanizmin e Rishikimit të Zbatimit, një proces rishikimi nga shtetet anëtare ku zbatimi i UNCAC nga çdo shtet shqyrtohet nga ekspertë të dy shteteve të tjera (Transparency International, 2008). Përmes Mekanizmit të Rishikimit të Zbatimit të Konventës, shtetet janë në gjendje të demonstrojnë dhe të raportojnë mbi masën në të cilën kanë arritur të zbatojnë Konventën dhe dispozitat e saj. Neni 12 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit thotë se çdo shtet duhet të marrë masa për të parandaluar korrupsionin në sektorin privat (Transparency International, 2008).

Transparency International në vitin 2002 paraqiti Parimet e Biznesit për Kundërshtimin e Korrupsionit. Këto parime u aplikuan për herë të parë për kompanitë e mëdha, sidoqoftë më vonë këto parime u zhvilluan gjithashtu edhe për kompanitë tjera në një botim të ri të parimeve për bizneset e vogla dhe të mesme. Këto parime janë rishikuar të paktën dy herë që kur ato janë prezantuar dhe njihen si një standard kryesor kundër korrupsionit dhe si një model për programet kundër korrupsionit (Transparency International, 2008).



5. PËRCEPTIMI I BIZNESEVE LIDHUR ME KORRUPSIONIN NË PËRGJITHËSI DHE KORRUPSIONIN NGA ANA E OFERTËS NË VEÇANTI

5.1. METODOLOGJIA E ANKETIMIT

Ky seksion ofron një përshkrim të përgjithshëm të qasjes metodologjike të aplikuar në këtë hulumtim. Për të analizuar korrupsionin nga ana e ofertës, më specifikisht për të identifikuar qëndrimet e bizneseve ndaj korrupsionit dhe gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë në aktivitete për të zbatuar parimet etike kundër korrupsionit, ekipi hulumtues i Institutit Riinvestit ka përdorur të dhënat primare të mbledhura përmes një ankete me bizneset që veprojnë në Kosovë. Për më tepër, ekipi gjithashtu ka përdorur shqyrtimin e literaturës dhe analizën krahasimore të të dhënave kualitative si kombinim i teknikave të hulumtimit, për të ofruar rezultatet më gjithëpërfshirëse të hulumtimit.

Të dhënat primare janë mbledhur me anë të anketës e cila ka përfshirë biznese në tërë rajonin e Kosovës. Mostra është ndërtuar nga baza e të dhënave të bizneseve aktive në Kosovë sipas komunave. Për t'u siguruar që ky hulumtim prodhon të dhëna reprezentative, mostra e përgjithshme është përbërë nga 500 respondentë në mbarë Kosovën, të cilët u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme.

Në aspektin gjeografik, mostra e bizneseve të anketuara pasqyron një përafrim të shpërndarjes aktuale, siç raportohet nga Agjencia Kosovare e Regjistrimit të Biznesit (ARBK). Përqindja më e madhe e bizneseve janë të përqendruara në rajonin e Prishtinës, duke u pasuar nga rajoni i Prizrenit, Gjilanit, Ferizajt dhe Pejës. Shpërndarja gjeografike e bizneseve të anketuara është paraqitur në Tabelën 1.

TABELA. 1 SHPËRNDARJA E BIZNESEVE SIPAS RAJONIT

Rajoni	Përqindja
Prishtinë	37%
Gjilan	8%
Pejë	10%
Ferizaj	12%
Prizren	16%
Mitrovicë	7%
Gjakovë	10%

BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE

Pyetëtori është hartuar në seksione, të cilat ishin para-caktuar bazuar në bazë të objektivave të projektit dhe hulumtimeve akademike të kryera nga ekipi hulumtues i Riinvest. Pyetëtori ka përbajtur pyetje të përgjithshme lidhur me profilin e bizneseve, konkretisht, pyetje mbi pronësinë dhe veprimtarinë afariste. Pjesa kryesore e pyetëtorit është përbërë nga pyetjet që kanë për synim sigurimin e informatave (sasiore dhe cilësore) lidhur me ndërgjegjësimin dhe perceptimin ndaj korrupsionit, përvojën e bizneseve me korrupsion, sjelljen e bizneseve kundër korrupsionit dhe gatishmërinë për të zbatuar parimet etike kundër korrupsionit.

Anketa është realizuar përmes angazhimit të anketuesve me përvojë, të cilët janë trajnuar mbi specifikat e anketës. Të gjithë anketuesit kanë kryer trajnim tre-ditorë, janë njoftuar lidhur me përbajtjen dhe rëndësinë e anketës; janë aftësuar në metodologjinë e anketimit (kontakti me të anketuarin, mënyrat e mbledhjes së informatave, mënyrat e mbushjes së pyetëtorit); dhe janë testuar mbi aftësinë e tyre për të kryer anketën përmes simulimit.

Para fillimit të anketimit, pyetëtori është testuar nga ekipi hulumtues i Riinvest-it për të siguruar efikasitetin të kohës dhe rrjedhën logjike të pyetjeve. Grupet e vogla me nga 2 deri 5 anketues kanë punuar nën mbikëqyrjen e një udhëheqësi të ekipit. Përveç monitorimit të anketuesve në terren dhe kryerjes së kontrollit logjik, verifikimi i anketave gjithashtu u bë përmes thirrjeve telefonike nga ekipi hulumtues dhe nga udhëheqësi i projektit. Rreth 40% e pyetësorëve nga anketa, të përzgjedhura në mënyrë rastësore, janë ri-verifikuar nga ekipi hulumtues, i cili ka kontaktuar të anketuarit për t'u siguruar se përgjigjet përputhen me ato të plotësuar nga anketuesi. Gjithashtu, secili pyetësor është verifikuar për të siguruar saktësi të plotësimit të pyetësorit dhe për të parë nëse ka përgjigje jo-logjike. Kjo metodologji përmirëson cilësinë e të dhënave dhe ndihmon në shmangien e defekteve të mundshme përbrenda vetë anketës.

Pas mbledhjes, të dhënat janë koduar nga hulumtuesit e Riinvestit, duke përdorur softuerin e dizajnuar posaçërisht për qëllime të projektit. Më tej, të dhënat janë analizuar dhe interpretuar duke përdorur softuerin SPSS për të identifikuar përgjigje që janë jashtë harkut të pritur, përfshirë edhe mospërputhje të mundshme tek të gjitha variablat. Gjithashtu, udhëheqësi i ekipit ka bërë kontrole periodike, kryesisht

përmes krahasimit të mesatares së variablave dhe shpërndarjeve në të gjithë skedarët, për t'u siguruar se të dhënat nuk janë ndryshuar, me qëllim apo pa. Analizat e hulumtimit të prezantuar në këtë raport bazohen kryesisht në statistika përshkruese, duke aplikuar teknikat e tabulimit të tërthortë (cross-tabulation). Pas tabulimit të të dhënave, ekipi hulumtues me përvojë është angazhuar në interpretimin dhe analizimin e të dhënave.

5.2. ANALIZA DHE PREZANTIMI I TË DHËNAVE

Ky seksion përshkruan dhe analizon rezultatet e pjesës kuantitative të studimit, anketës së kryer me 500 biznese që operojnë në shtatë (7) rajone të Kosovës. Nën-seksioni 5.2.1 paraqet profilin e përgjithshëm dhe pasqyrën e ndërmarrjeve. Nën-seksioni 5.2.2 analizon ndërgjegjësimin dhe perceptimin e bizneseve kosovare lidhur me korrupsionin. Nën-seksioni 5.2.3 analizon ndërgjegjësimin mbi pasojat e korrupsionit. Nën-seksioni 5.2.4 përshkruan origjinën (burimet) e korrupsionit. Nën-seksioni 5.2.5 paraqet përvojat e bizneseve me korrupsion dhe nën-seksioni 5.2.6 analizon sjelljen e bizneseve ndaj korrupsionit dhe vullnetit për zbatimin e parimeve të etikës.

5.2.1 Profili i bizneseve

Kompanitë që janë intervistuar për qëllime të anketimit kanë qenë kryesisht në rajonin e Prishtinës (37%), pasuar nga rajoni i Prizrenit (16%), Ferizajit (12%), Pejës dhe Gjakovës (10% secila), Gjilanit (8%) dhe Mitrovicës (7%). Këto përqindje përputhen me pasqyrën e përgjithshme të bizneseve që operojnë në Kosovë, pasi shumica e tyre janë të vendosura në rajonin e Prishtinës. Po ashtu, shumica e të anketuarve ishin pronarë (68%) dhe menaxherë (23%). Rreth 77% e kompanive menaxhohen nga vetë pronarët, afërsisht 11% nga menaxheri dhe 12% menaxhohen së bashku nga pronari dhe menaxheri. Kjo kryesisht vjen nga fakti se shumica e bizneseve që veprojnë në Kosovë janë ndërmarrje mikro dhe të vogla të cilat janë zakonisht të menaxhuara nga pronari. Shumica dërrmuese e bizneseve janë në pronësi individuale (78%), 15% janë kompani me përgjegjësi të kufizuar, 3% janë shoqëri të përgjithshme. Numri mesatar i të punësuarve në një kompani është 6.96. Krahasuar me vitet e mëparshme, numri mesatar është zvogëluar paksa pasi në vitin 2016 numri mesatar i të punësuarve ishte 8.5 (Instituti Riinvest, 2017).

5.2.2 Vetëdijesimi dhe perceptimi i bizneseve kosovare lidhur me korrupsionin


Ky seksion do të paraqesë perceptimin e bizneseve lidhur me korrupsionin në Kosovë. Më tej, kjo pjesë do të elaboroj edhe nivelin e vetëdijes së bizneseve rreth praktikave korruptive në Kosovë.

Në pyetjen se në çfarë niveli mendojnë se korrupsioni është i përhapur në Kosovë në përgjithësi, rreth 91% e bizneseve kanë përshtypje se korrupsioni është ose i përhapur ose shumë i përhapur dhe 9% mendojnë se nuk është i përhapur (shih figurën 1 për detaje). Rezultatet e tilla tregojnë se pothuajse të gjitha bizneset mendojnë se korrupsioni është mjaft i përhapur në Kosovë. Kurse, në pyetjen se sa i përhapur është korrupsioni në sektorin e tyre përkatës, rezultatet janë pothuajse të shpërndara në mënyrë të barabartë me 48% që mendojnë se korrupsioni është i përhapur ose shumë i përhapur dhe 52% që mendojnë që nuk është i përhapur (shih figurën 1 për detaje). Rezultatet e tilla tregojnë se kur krahasojmë korrupsionin në Kosovë në

përgjithësi me korrupsionin në një sektor të caktuar, bizneset janë te prirura të mendojnë se korrupsioni është më i përhapur në Kosovë në përgjithësi. Kjo mund të jetë për shkak të faktit se korrupsioni tenton të perceptohet më shumë në sektorin publik dhe jo në sektorin privat. Gjithashtu, kjo tregon se ka mungesë të vetëdijesimit nga ana e bizneseve lidhur me korrupsionin që mbizotëron në sektorin privat.

Kjo mbështetet nga rezultatet që tregojnë se 78% e bizneseve mendojnë se korrupsioni është i përhapur ose shumë i përhapur në prokurimin publik që menaxhohet nga autoritetet qeveritare. Ndërkohë 22% mendojnë se nuk është e përhapur (shih Fig.1 për detaje). Rreth 68% mendojnë se korrupsioni është i përhapur ose shumë i përhapur në prokurimin publik që menaxhohet nga autoritetet lokale. (shih Fig.1). Si rrjedhojë, një përqindje pak më e lartë e bizneseve mendojnë se korrupsioni është i përhapur në prokurimin publik që menaxhohet nga autoritetet e qeverisë qendrore kundrejt atij të menaxhuar nga autoritetet lokale.

FIGURA. 1 PERCEPTIMI I KORRUPSIONIT




BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE

Rreth 65% e të anketuarve ose pajtohen ose pajtohen deri në një farë mase me formulimin se asnjë shërbim që është i lidhur me institucionet publike nuk mund të merret pa dhënë ryshfet. Më konkretisht, 19% pajtohen, ndërsa 46% pajtohen në një farë mase dhe pjesa tjetër nuk pajtohen. Rreth 59% ose bien pajtohen ose pajtohen në një farë mase me deklaratën se asnjë shërbim që është i lidhur me institucionet publike nuk mund të merret pa dhënë dhurata (16% pajtohen dhe 43% pajtohen në një farë mase). Rezultatet e tilla tregojnë se biznesi ka perceptimin se dhënia e ryshfetit është pak më e zakonshme sesa dhënia e dhuratave.

Në pyetjen nëse është e justifikueshme t'u jepet ryshfet ose dhurata zyrtarëve publikë për të kryer një punë që lidhet me biznesin e tyre, 82% deklaruan se nuk është fare e justifikueshme, 14% mendojnë se është disi e justifikueshme dhe vetëm 3.6% se është e justifikueshme (shih Fig. 2). Kjo tregon se bizneset janë të vetëdijshëm se dhënia e ryshfetit për të bërë diçka nuk është një veprim i justifikueshëm. Ndërkohë një vlerësim i korrupsionit i kryer nga Instituti Riinvest (2016) ka treguar se pothuajse një në dy qytetarë në Kosovë do të pranonte një lloj të praktikës korruptive, duke treguar një nivel të lartë të tolerancës ndaj korrupsionit administrativ. Një krahasim mes shteteve tregon se toleranca ndaj korrupsionit në Kosovë është e lartë në krahasim me tolerancën e korrupsionit në vendet e tjera në Evropën Juglindore (Instituti Riinvest, 2016). Duke krahasuar rezultatet, mund të shihet se niveli i tolerancës së bizneseve ndaj praktikave korruptive është më i ulët. Kur pyetja u kryqëzua me madhësinë e kompanisë, nuk u vërejtën dallime. Pa marrë parasysh madhësinë e biznesit, 82% e bizneseve mendojnë se nuk është fare e justifikueshme t'i japë ryshfet ose dhurata zyrtarëve publikë për të përfunduar një punë që lidhet me biznesin e tyre.

FIGURA. 2 DHËNIA E RYSHFETIT OSE DHURATAVE ZYRTARËVE PUBLIKË




BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE

Bizneset gjithashtu u pyetën se si duhet të përgjigjet një zyrtar i biznesit nëse një zyrtar publik i kërkon ryshfet ose një dhuratë në këmbim të shërbimeve, dhe rezultatet tregojnë se 43% besojnë se zyrtarët e biznesit duhet ta refuzojnë kërkesën menjëherë, 40% besojnë se zyrtari i biznesit duhet të raportojnë zyrtarët publik që kërkojnë ryshfet tek autoritetet kom-

petente, 11% mendojnë se zyrtari i biznesit duhet të mendojë për një kohë para se të vendosë të japë ryshfet ose dhuratë, dhe 6% mendojnë se zyrtari duhet të pajtohet të japë ryshfet, përndryshe ai nuk do të jetë në gjendje ta kryejë punën (shih Fig.3). Rezultatet si këto, tregojnë se respondentët shprehin një nivel të lartë të intolerancës ndaj korrupsionit.

FIGURA. 3 REAGIMI I BIZNESEVE KUR NJË ZYRTAR PUBLIK KËRKON RYSHFET




BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE

Kur krahasojmë për diferencat në opinion sipas madhësisë së bizneseve, opinioni i ndërmarrjeve mikro nuk dallon shumë nga rezultatet e përgjithshme. Një arsye për këtë mund të jetë fakti se më shumë se 90% e ndërmarrjeve në Kosovë janë mikro dhe kështu ato përbëjnë pjesën më të madhe të mostrës e cila është projektuar të jetë përfaqësuese. Ndërmarrjet e vogla tregojnë disa dallime, pasi rreth 14% mendojnë se

zyrtari duhet të japë ryshfet, përndryshe ai nuk do të ishte në gjendje ta përfundonte një punë. Ndërkohë, ndërmarrjet e mesme mendojnë se zyrtari i biznesit duhet të refuzojë kërkesën menjëherë ose të raportojë zyrtarin publik që kërkon ryshfet tek autoritetet kompetente. Kështu duke treguar se ndërmarrjet e mesme kanë një nivel më të ulët të tolerancës ndaj korrupsionit (shih Fig.4).

FIGURA. 4 MADHËSIA E BIZNESIT DHE REAGIMI I BIZNESEVE KUR ZYRTARI PUBLIK KËRKON RYSHFET



BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE

Ndërkohë, në përpjekje për të kuptuar nivelin e korrupsionit brenda sektorit, ekipi u ka kërkuar bizneseve të vlerësojnë përqindjen e bizneseve që veprojnë në sektorin e tyre dhe që japin ryshfet për të kryer ndonjë lloj pune. Një metodë e tillë nuk mat nivelin e korrupsionit drejtpërdrejt. Në pamundësi për të matur drejtpërdrejtë, metoda e anketimit në formë të tërthortë është treguar se është më e përshtatshme për të marrë informacion nga kompanitë për nivelin e korrupsionit. Argumentet për metodologjinë e përdorur kryesisht konsistojnë në faktin që studimet që kanë pasur target ekonominë në tranzicion kanë përdorur sondazhet dhe pyetjet indirekte si më të përshtatshme. Rezultatet tregojnë se 25% e bizneseve paguajnë ryshfet. Kjo përqindje është pak më e ulët se kur janë pyetur se sa është i përhapur korrupsioni në sektorin e tyre, pasi 48% besojnë se është i përhapur ose shumë i përhapur (23% besojnë se është i përhapur dhe 25% besojnë se është shumë i përhapur). Megjithatë, 25% është ende një përqindje e lartë pasi që do të thotë që një në çdo katër biznese paguan ryshfet ose jep dhurata për ta përfunduar një punë. Kur krahasojmë për diferencat në opinion sipas madhësisë së bizneseve, ndërmarrjet mikro mendojnë se 25% e bizneseve paguajnë ryshfet, ndërmarrjet e vogla mendojnë se 31% e bizneseve paguajnë

ryshfet dhe ato të mesme mendojnë se vetëm 11% e bizneseve paguajnë ryshfet.

Ekipi gjithashtu u ka kërkuar bizneseve të vlerësojnë nivelin e pranueshmerisë të disa praktikave në rast se ato aplikohen nga zyrtarët e bizneseve private. Rreth 86% e bizneseve deklaruan se është shumë e papranueshme ose e papranueshme për ta që ti ofrojnë drekë/darkë falas një zyrtari publik në mënyrë që ai ta zgjidhë një problem që lidhet me biznesin e tyre. Pjesa e mbetur prej 14% besojnë se është e pranueshme ose shumë e pranueshme. Një përqindje e tillë është shqetësuese pasi që tregon se për një në çdo shtatë biznese është e pranueshme që ti ofrohet drekë/darkë falas një zyrtari publik në mënyrë që të zgjidhet një problem që lidhet me biznesin.

Një praktikë tjetër e përdorur ishte se sa e pranueshme është që një zyrtar i biznesit t'i ofrojë një favor ndonjë zyrtari publik në mënyrë që në kthim zyrtari publik t'i ndihmon atyre në zgjidhjen e ndonjë problemi. Rezultatet tregojnë se 86% deklaruan se është shumë e papranueshme ose e papranueshme për të bërë një favor për një zyrtar publik, kështu që zyrtari publik në kthim do t'i ndihmonte ata në zgjidhjen e një problemi. Ndërkohë, 14% besojnë se


është e pranueshme ose shumë e pranueshme për të ofruar një favor.

Një praktikë tjetër e listuar ishte se sa e pranueshme është për një zyrtar të biznesit t'i japë një dhuratë një zyrtari publik në mënyrë që zyrtari publik t'i ndihmon ata të zgjidhnin një problem. Rreth 90% besojnë se është shumë e papranueshme ose e papranueshme. Pjesa e mbetur prej 10% beson se është e pranueshme ose shumë e pranueshme për t'i dhënë një dhuratë një zyrtari publik. Duke nënkuptuar se për çdo të dhjetin biznes është e pranueshme t'i jepet një dhuratë një zyrtari publik.

Një praktikë tjetër e listuar ishte se sa e pranueshme është që një zyrtar i biznesit t'i japë para një zyrtari publik në mënyrë që zyrtari publik t'i ndihmon ata në zgjidhjen e ndonjë problemi. Pothuajse 93% besojnë se është shumë e papranueshme ose e papranueshme. Pjesa e mbetur prej 7% besojnë se është e pranueshme ose shumë e pranueshme (4% - e pranueshme dhe 3% - shumë e pranueshme). Duke treguar se një përqindje më e lartë e bizneseve mendojnë se nuk është e pranueshme që një zyrtar i biznesit të japë para një zyrtari publik në krahasim me dhënien e dhuratave ose kryerjen e favoreve.

Bizneset gjithashtu u pyeten për të njëjtat praktika, por nga këndvështrimi i zyrtarëve publik. Rreth 83% e të anketuarve deklaruan se është e papranueshme ose shumë e papranueshme që një zyrtar publik të pranojë një ftesë për drekë/darkë nga një zyrtar i biznesit për ta ndihmuar biznesin të zgjidhë një problem. Pjesa e mbetur prej 17% besojnë se është e pranueshme. Lidhur me praktikën e pranimit të një favor nga një zyrtar i biznesit në këmbim për zgjidhjen e një problemi lidhur me biznesin, 88% mendojnë se është e papranueshme ose shumë e papranueshme, ndërkohë që 12% mendojnë se është e pranueshme. Ngjashëm janë rezultatet për praktikën e pranimit të një dhurate nga një zyrtar i biznesit, pasi 89% e të anketuarve mendojnë se është e papranueshme ose shumë e papranueshme që një zyrtar publik të pranojë një dhuratë nga një zyrtar i biznesit. Ndërkohë 11% mendojnë se është e pranueshme. Pothuajse 92% mendojnë se është e papranueshme që një zyrtar i biznesit të pranojë para nga një zyrtar i biznesit në këmbim për zgjidhjen e një problemi të lidhur me biznesin, ndërkohë që 8% mendojnë se është e pranueshme (shih figurën 5 për detaje). Duke treguar përsëri se një përqindje më e lartë e bizneseve mendojnë se nuk është e pranueshme që një zyrtar publik të pranojë para nga një zyrtar i biznesit krahasuar me pranimin e dhuratave apo favoreve.

FIGURA. 5 NIVELI I PRANIMIT PËR PRAKTIKAT E BËRA NGA BIZNESET DHE ZYRTARËT PUBLIKË



BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE

5.2.3 Vetëdijesimi për pasojat

Sa i përket vetëdijesimit të bizneseve, rezultatet tregojnë se rreth 97% e bizneseve pajtohen apo pajtohen deri në një masë me deklaratën se korrupsioni dëmton sundimin e ligjit, konkurrencën dhe zhvillimin e vendit.

Në deklaratën korrupsioni pengon rritjen ekonomike, rrit kostot e biznesit dhe dekurajon investimet, 97% e të anketuarve pajtohen ose pajtohen në një farë mase. Në pyetjen se a pajtohen me deklaratën se korrupsioni siguron një zhvillim afatgjatë të kompanisë, rreth 48% pajtohen apo pajtohen në një farë mase. Pothuajse 16% e të anketuarve janë pajtuar me deklaratën. Kjo tregon se çdo i gjashti biznes mendon se përmes korrupsionit sigurohet rritja afatgjate e kompanisë. Ndërkohë, 32% pajtohen deri diku me këtë deklaratë. Një rezultat i tillë mund të jetë i ndikuar nga mjedisi i biznesit në Kosovë dhe perceptimit se korrupsioni është i përhapur. Një pjesë e bizneseve mund të mendojnë se mënyra e vetme që një kompani të zhvillohet është përmes angazhimit në praktika korruptive. Pothuajse 97% e të anketuarve pajtohen apo janë dakord deri diku me deklaratën se përfshirja në praktikën korruptive dëmton konkurrencën e ndershme dhe vetë kompaninë në planin afatgjatë. Në pyetjen nëse janë dakord me deklaratën se rruga e vetme për zhvillim afatgjatë të kompanisë është konkurrenca e ndershme, 96% e të anketuarve pajtohen ose pajtohen deri diku.

Katër praktika të korrupsionit të perceptuara nga ana e bizneseve si më të përhapura në Kosovë janë rryshfeti, informaliteti (nën deklarimi i qarkullimit për qëllime tatimore), mos pagesa e TVSH-së dhe favorizimi i miqve dhe anëtarëve të familjes në institucionet publike. Për më tepër, çështjet më problematike për zhvillimin e biznesit në Kosovë u konsideruan të jenë korrupsioni me 76.5 pikë intensiteti dhe nepotizmi me 71.7 pikë intensiteti¹. Për të kuptuar pengesat me të cilat bizneset ballafaqohen për të bërë biznes, ekipi u kërkoi atyre që të rangojnë pengesat sipas intensitetit ku pikat për secilën barrierë mund të variojnë nga një minimum prej 20 pikësh në një maksimum prej 100 pikësh, ku një intensitet më i lartë tregon një

nivel më të lartë të ndikimit negativ në rritjen e biznesit. Barrierat e tjera të tilla si procedurat komplekse administrative, ndryshimet e shpeshta të ligjeve dhe rregulloreve, mungesa e mjeteve ose procedurave për të mbledhur borxhin nga të tjerët, niveli i taksave, qasja në financa ose kostot e financimit dhe qasja në shërbimet publike shënuan rezultate të intensitetit në mes të 60-tave.

5.2.4 Origjina (burimet) e korrupsionit

Bizneset janë pyetur gjithashtu nëse lidhjet e ngushta midis biznesit dhe politikës çojnë në korrupsion dhe 91% e të anketuarve pajtohen ose pajtohen deri diku me deklaratën (shih Figurën 6 për detaje). Shumica e bizneseve janë të vetëdijshme se lidhjet e ngushta mes biznesit dhe politikës mund të çojnë në praktika korruptive. Për më tepër, rreth 80% pajtohen apo pajtohen deri diku me deklaratën se dhënia e rryshfetit dhe përdorimi i lidhjeve shpesh është mënyra më e lehtë për të marrë shërbime të caktuara publike. Këto rezultate japin indikacione lidhur me perceptimin e bizneseve rreth asaj se sa është korrupsioni i përhapur në Kosovë. Shumica e bizneseve duket se pajtohen se mënyra më e lehtë për të pasur qasje në shërbime publike është përmes dhënies së rryshfetit dhe përdorimit të lidhjeve. Kjo është shqetësuese pasi që bizneset që kanë lidhje fitojnë avantazh konkurrues në krahasim me ata që nuk kanë.

Sa i përket financimit të partive politike, 65% nuk pajtohen me deklaratën se ka transparencë dhe kontroll të mjaftueshëm sa i përket financimit të partive politike. Ndërkohë, 35% pajtohen deri në një farë mase apo pajtohen plotësisht. Mungesa e transparencës dhe kontrollit mbi financimin e partive politike mund të çojë në korrupsion pasi bizneset mund të financojnë partitë politike në këmbim të favoreve. Gjithashtu, shumica e bizneseve mendojnë se procesi nuk është transparent që tregon se mund të ketë korrupsion. Kjo pikëpamje mbështetet gjithashtu nga shumë raporte të cilat në të vërtetë tregojnë se ka mungesë transparence dhe kontrolli lidhur me financimin e partive politike.

Në pyetjen nëse pajtohen me deklaratën se mënyra


¹ Për çdo pengesë, renditja e dhënë nga secili biznes (nga 1-4) shumëzohet me një peshë të barabartë me renditjen (gjithashtu 1 deri 4), d.m.th. pengesat më serioze marrin një peshë më të lartë. Mesatarja e ponderuar pastaj pjesëtohet me 4 (renditja maksimale) dhe shumëzohet me 100 për të konvertuar rezultatin në një përqindje që tregon se sa afër renditjes maksimale është renditja mesatare. Me fjalë të tjera, rezultati është llogaritur si: $s = \{ \sum (w_i / n) * 100/4 \}$, ku $w_i = x_i$; s është rezultati për intensitetin e çdo pengese, w është pesha, x është renditja e dhënë nga secili i anketuar dhe i = 1, 2, ..., n paraqet secilin respondent.

e vetme që një biznes të ketë sukses është përmes lidhjeve politike, rreth 62% e të anketuarve pajtohen apo pajtohen deri diku me deklaratën. Kjo tregon se ekziston një perceptim midis bizneseve se nevojiten lidhje politike në mënyrë që një biznes të jetë i suksesshëm. Kjo pikëpamje mund të ndikohet nga perceptimi i përgjithshëm rreth korrupsionit në Kosovë në përgjithësi. Një këndvështrim i tillë mund të ndikojë në mënyrë indirekte në konkurrencë pasi që bizneset që nuk kanë lidhje politike nuk mund të zhvillohen për shkak të frikës se nuk kanë atë që nevojitet, ndërkohë që ato që kanë lidhje mund të zhvillohen dhe rriten

pikërisht për shkak të lidhjeve politike. Rreth 92% e të anketuarve pajtohen ose pajtohen në një masë që favorizimi dhe korrupsioni pengojnë konkurrencën në biznes. Kjo tregon se bizneset janë të vetëdijshme për ndikimet negative të korrupsionit në konkurrencë.

Pothuajse 51% e të anketuarve pajtohen ose pajtohen në një farë mase se masat kundër korrupsionit zbatohen në mënyrë të paanshme dhe pa asnjë motiv alternativ. Kjo tregon se bizneset besojnë se ekziston një zbatim i pjesshëm i masave kundër korrupsionit. Kjo çon në një konkurrencë të padrejtë e cila është një

FIGURA. 6 NIVELI I PAJTIMIT ME DEKLARATA TË CAKTUARA



BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE

Për të kuptuar shpeshtësinë e dhënies së ryshfetit për procedura të caktuara, ekipi ka pyetur në mënyrë specifike se sa i shpeshtë është fenomeni i dhënies së ryshfetit ose dhuratave për procedura të caktuara administrative. Për lëshimin e lejeve të ndërtimit, rreth 86% e të anketuarve deklaruan se ndodh shpesh ose shumë shpesh. Ndërkohë, 14% pohuan se ndodh rrallë ose nuk ndodh kurrë. Arsyeja për këtë përqindje shumë të lartë mund të jetë për shkak të faktit se marrja e lejeve të ndërtimit është një procedurë shumë burokratike që kërkon kohë dhe bizneset mund ta kenë më të lehtë dhënien e ryshfetit për t'u siguruar që ata marrin lejen. Rreth 86% deklaruan se ndodh shpesh ose shumë shpesh për të dhënë ryshfet gjatë proceseve të tenderimit në procedurat e prokurimit publik. Ndërkohë, 14% pohuan se ndodh rrallë ose se nuk ndodh kurrë. Bizneset ende besojnë se prokurimi publik është i korruptuar.


Lidhur me praktikën e marrjes së kontratave me institucionet publike pa procese tenderuese, 81% e të anketuarve kanë deklaruar se ndodh shpesh ose shumë shpesh, 19% kanë deklaruar se ndodh rrallë ose se nuk ndodh kurrë (shih Fig.7 për detaje). Bizneset besojnë se bizneset e tjera shpesh paguajnë ryshfete ose japin dhurata për të fituar kontrata pa një proces tenderimi. Frekuencë më e ulët është vërejtur kur flasim për qasjen në shërbime publike, pasi 67% e bizneseve kanë deklaruar se nuk ndodh kurrë ose që ndodh rrallë, ndërkohë që 33% kanë deklaruar se ndodh shpesh ose ndodh shumë shpesh. Rezultatet e tilla tregojnë se perceptimi për korrupsionin është më i ulët kur bëhet fjalë për qasjen në shërbimet publike siç janë energjia elektrike, uji, ngrohja, mbeturinat, etj.

Mbledhja e tatimeve ishte një procedurë tjetër e listuar dhe rreth 65% e të anketuarve deklaruan se ndodh shpesh ose shumë shpesh, ndërkohë 35% thanë se ndodh rrallë ose se nuk ndodh kurrë. Perceptimi i bizneseve është se bizneset shpesh duhet të japin ryshfete ose dhurata gjatë procesimit të taksave. Mitoja mund të jepet për të zvogëluar shumën e taksave që duhet paguar një biznes.

Në pyetjen për kalimin e mallrave përmes doganave, rreth 71% e të anketuarve kanë deklaruar se ndodh shpeshherë ose shumë shpesh që të japin ryshfet ose dhuratat, ndërkohë që 29% kanë deklaruar se ndodh rrallë ose se nuk ndodh kurrë. Kjo tregon se bizneset mendojnë se dhënia e ryshfetit ndodh shpesh gjatë kalimit të mallrave nëpërmjet doganave. Kjo mund të ndodhë në mënyrë që të ulët shumën e vlerës që duhet të paguhet në doganë ose të mos paguajnë fare taksat. Pothuajse 72% e të anketuarve deklaruan se ryshfeti ose dhënia e dhuratave ndodh shpesh ose shumë shpesh gjatë procedurave gjyqësore. Ndërkohë, 28% deklaruan se ndodh rrallë ose se nuk ndodh kurrë. Rreth 66% e të anketuarve deklaruan se ryshfeti ose dhënia e dhuratave ndodh shpesh gjatë inspektimeve në zyrat e kompanisë, 34% mendojnë se ndodh rrallë ose se nuk ndodh kurrë. Një rezultat i tillë tregon se bizneset shpesh duhet të paguajnë ryshfet ose t'u japin dhurata inspektorëve. Kjo çon në konkurrencë të pandershme.

Rezultatet nënkuptojnë se perceptimi i bizneseve është se korrupsioni është kryesisht i përhapur në dhënien e lejeve të ndërtimit, në prokurim publik dhe në marrjen e kontratave nga institucionet publike pa një procedurë tenderimi. Gjithsesi, perceptimi është gjithashtu i lartë edhe për praktikën e tjera por më i lartë për këto tri praktika.

FIGURA. 7 SHPESHTËSIA E DHËNIES SË RYSHFETIT PËR PROCEDURA TË CAKTUARA




BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE

Sa i përket sjelljeve specifike, rreth 75% e të anketuarve deklaruan se nuk është aspak e pranueshme ose jo e pranueshme që bizneset të përfitojnë nga kontaktet dhe marrëdhëniet brenda institucioneve publike në mënyrë që të iu shpejtohen procedurat lidhur me biznesin e tyre. Ndërkohë, 25% mendojnë se është e pranueshme ose shumë e pranueshme. Një rezultat i tillë nënkupton që çdo i katërti biznes mendon se është e pranueshme të përdoren lidhjet në mënyrë që të përshpejtohen procedurat lidhur me biznesin. Kjo mund të jetë si rezultat i aspekti kulturor pasi që në Kosovë është deri diku e zakonshme që të përdoren kontaktet në institucionet publike për të përfunduar ndonjë punë/procedurë.

Po ashtu, 83% e të anketuarve mendojnë se nuk është aspak e pranueshme ose është e papranueshme që zyrtarët publikë të përdorin burime publike për inte-

resa ose përfitime private. Pothuajse 17% mendojnë se është e pranueshme ose shumë e pranueshme. Rezultate të ngjashme janë për praktikën e përdorimit të burimeve publike nga zyrtarët publik për interes të një pale të tretë, pasi 87% mendojnë se nuk është e pranueshme dhe 13% mendojnë se është. Megjithëse shumica e bizneseve janë të vetëdijshëm se përdorimi i burimeve publike nga zyrtarët publikë për përfitime private ose interesa të një pale të tretë është dukuri negative, kurse një përqindje e vogël ende mendon se kjo është një praktikë e pranueshme. Për më tepër, 83% e të anketuarve mendojnë se nuk është aspak e pranueshme ose e papranueshme për një zyrtar publik që të mbajë një funksion publik, ndërsa ka interesa në një kompani private. Ndërkohë 17% mendojnë se është e pranueshme ose shumë e pranueshme (Shih Figurën 8 për detaje).

FIGURA. 8 NIVELI I PRANIMIT TË SJELLJEVE SPECIFIKE



- Kryerja e funksioneve publike ndërkohë që ka një interes në kompanitë private
- Shfrytëzimi i burimeve publike nga zyrtarët publikë në interes të një pale të tretë
- Përdorimi i burimeve publike nga zyrtarët publikë për interesa privat ose përfitime
- Shfrytëzimi i marrëdhënieve dhe kontakteve në institucionet publike për të shpejtuar procedurat


BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE

5.2.5 Përvoja e bizneseve me korrupsion

Meqenëse perceptimi rreth korrupsionit në prokurimin publik është i lartë, ekipi ka pyetur bizneset në mënyrë të veçantë për përvojat e tyre me korrupsionin në prokurimin publik. Më konkretisht, ekipi u ka kërkuar bizneseve të japin mendimet e tyre lidhur me atë se sa të përhapura janë praktika të caktuara në prokurimin publik. Për shembull, 67% e bizneseve mendojnë se abuzimi me procedurat e negociuara është një praktikë shumë e përhapur ose e përhapur, ndërkohë që 33% mendojnë se nuk është e përhapur ose nuk është aspak e përhapur. Rreth 64% besojnë se praktika e abuzimit në baza urgjente për të justifikuar përdorimin e procedurave jo konkurruese ose të shpejta është e përhapur ose shumë e përhapur. Pothuajse 36% besojnë se kjo praktikë nuk është e përhapur ose nuk është fare e përhapur. Lidhur me praktikën e

përdorimit të kriterëve të paqarta të përzgjedhjes ose vlerësimit, 74% e të anketuarve besojnë se kjo është një praktikë e përhapur ose shumë e përhapur, 26% besojnë se nuk është e përhapur ose se nuk është aspak e përhapur. Praktika e konfliktit të interesit në vlerësimin e ofertave besohet të jetë e përhapur ose shumë e përhapur nga 77% e të anketuarve, ndërkohë që 23% besojnë se nuk është e përhapur ose se nuk është aspak e përhapur. Praktika e dizajnit të specifikimeve të përshtatura për kompanitë specifike besohet të jetë e përhapur nga 78% e ndërmarrjeve ndërkohë që 22% besojnë se nuk është e përhapur ose se nuk është aspak e përhapur. Praktika e ndryshimit të kushteve të kontratës pas mbylljes së procedurës (p.sh aneks kontratat) 64% e të anketuarve besojnë se është e përhapur dhe 36% besojnë se nuk është e përhapur ose se nuk është shumë e përhapur (shih Fig. 9).

FIGURA. 9 SA TË PËRHAPURA JANË PRAKTIKAT E CAKTUARA NË PROKURIMIN PUBLIK



BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE

Rreth 20% e bizneseve të anketuara kanë deklaruar se kanë marrë pjesë në procedurat e tenderit publik në tri vitet e fundit. Prej tyre, 44% kanë marrë pjesë vetëm një herë dhe pjesa tjetër, 56%, kanë marrë pjesë më shumë se një herë. Nga bizneset që kanë marrë pjesë në procedurat e tenderit publik, rreth 34% besojnë se korrupsioni ka penguar kompaninë e tyre nga fitimi i një tenderi ose marrja e një kontrate të prokurimit publik. Rreth 26% nuk mendojnë kështu dhe 32% nuk ishin të sigurt ose nuk dinin. Kjo tregon se çdo i treti biznes që ka marrë pjesë në proceset e prokurimit publik mendon se korrupsioni i pengon ata që të fitojnë një tender. Një perceptim i tillë mund të shtyjë bizneset që të mos aplikojnë për tenderë pasi mendojnë se një kompani që ka lidhje do të marrë kontratën.

Nga bizneset që kurrë nuk kanë marrë pjesë në ndonjë procedurë të prokurimit publik, rreth 12% kanë deklaruar se nuk e kanë bërë këtë sepse kanë pasur mendimin se marrëveshja tashmë është bërë para se të hapet thirrja për oferta, 7% kanë deklaruar se nuk kanë aplikuar për shkak se kriteret

dukeshin sikur të ishin përshtatur për dikë tjetër, 7% nuk kanë aplikuar sepse afati i fundit për dorëzimin e tenderit ishte i shkurtër dhe i pamundur për t'u arritur. Pothuajse 5% thanë se procedura e aplikimit ishte e komplikuar dhe shumë burokratike. Shumica, 53%, thanë se ishte për arsye të tjera. Rreth 31% e kompanive kanë deklaruar se nuk kanë aplikuar nga frika se procedura e prokurimit publik është caktuar tashmë për një kompani tjetër ose për shkak se afati ishte shumë i shkurtër. Një përqindje e tillë tregon se një numër relativisht i lartë i kompanive nuk kanë besim në procedurat e prokurimit publik. Të anketuarve gjithashtu u pyetën nëse biznesi i tyre ka qenë në kontakt gjatë tre viteve të fundit me ndonjë zyrtar publik madje edhe përmes një ndërmjetësi për disa procedura administrative dhe rezultatet tregojnë se 8% kanë qenë në kontakt me një zyrtar për proceset e tenderimit në procedurat e prokurimit publik, 10% ishin në kontakt me një zyrtar publik për të siguruar kontrata me institucionet publike pa proces tenderimi, 6% ishin në kontakt me një nëpunës doganor, 26% ishin në kontakt me zyrtarët për procedurat lidhur me


rregulloret e punës (duke përfshirë inspektimet në vend) dhe 6% ishin në kontakt me zyrtarët publikë për blerjen ose përtëritjen e licencave për ushtrimin e veprimtarisë afariste.

Në pyetjen nëse në tri vitet e fundit ka pasur ndonjë rast kur ndonjë zyrtar publik u ka kërkuar që t'i jepnin ndonjë dhuratë, ryshfet ose të bënin ndonjë favor, pothuajse 7% e bizneseve deklaruar se një kërkesë e tillë u ishte bërë, ndërsa 86% kanë deklaruar se asnjë kërkesë e tillë nuk ishte bërë dhe 7% nuk ishin të sigurt. Nga ata që kishin një kërkesë të tillë, 10% e kanë raportuar zyrtarin tek autoritetet kompetente, 70% nuk e kanë raportuar zyrtarin dhe 20% nuk kanë ditur se çfarë ka ndodhur. Rezultatet e tilla tregojnë se një numër shumë i madh i bizneseve nuk i raportojnë zyrtarët që u kërkojnë ryshfete ose dhurata. Më tej, kur krahasojmë për madhësinë e biznesit mund të vërehet se bizneseve të mesme iu është kërkuar ryshfet më shumë, pasi që 11% e bizneseve të mesme kanë deklaruar se kishin marrë një kërkesë të tillë. Rreth 8% e bizneseve të vogla dhe 6% e bizneseve mikro kanë deklaruar se një zyrtar publik u ka kërkuar

ryshfet. Po ashtu, asnjë nga bizneset e mesme nuk kanë raportuar zyrtarin që u ka kërkuar ryshfet tek autoritetet kompetente, ndërkohë që rreth 10% e bizneseve mikro dhe 10% e bizneseve të vogla kanë raportuar zyrtarin.

Nga bizneset që kanë raportuar zyrtarët, rreth 4% e kanë bërë një gjë të tillë në polici, 35% në Agjencinë kundër Korrupsionit, 13% në institucionin ku punon zyrtari. Pjesa tjetër e të anketuarve nuk ishin të sigurt se ku u raportua zyrtari. Sa i përket pasojave, 15% e bizneseve kanë deklaruar se sapo kanë raportuar zyrtarët janë iniciuar procedura formale kundër tij/saj, 5% kanë deklaruar se problemi është zgjidhur joformalisht dhe paratë/dhuratat janë kthyer tek ata, 5% kanë deklaruar se ata janë këshilluar që të mos vazhdojnë më tej procesin, 10% kanë deklaruar se kanë pasur pasoja negative si rezultat i raportimit të incidentit dhe 40% kanë deklaruar se asgjë nuk ka ndodhur (shih Figurën 10). Rezultatet tregojnë se një përqindje shumë e ulët e zyrtarëve që kanë qenë të angazhuar në praktikat korruptive janë përballur me pasoja.

FIGURA. 10 PASOJAT E RAPORTIMIT TË ZYRTARËVE PUBLIKË TË KORRUPTUAR



BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE

Shumica e kompanive nuk e kanë raportuar fare zyrtarin, dhe për 16% e të anketuarve arsyeja ishte se dhënia e parave ose dhuratave zyrtarëve publikë është një praktikë e zakonshme dhe si e tillë nuk ka nevojë të raportohet. Për 26% e të anketuarve arsyeja për mos raportim ishte se ata e konsiderojnë të pa nevojshëm pasi askush nuk do të merret me rastin e raportuar. Kjo tregon se çdo i katërti biznes mendon se nuk ia vlen të raportohet një zyrtar pasi autoriteti kompetent nuk do të merret me rastin. Kjo ndikon që bizneset të humbin besimin në sistem dhe të mos i raportojnë zyrtarët e korruptuar të cilët mund të vazhdojnë të veprojnë pa asnjë problem. Për 11% arsyeja ishte se ata nuk e kishin të qartë se ku duhet të raportojnë zyrtarët publikë. Rreth 9% nuk e raportuan zyrtarin për shkak të frikës nga ndëshkimi. Rreth 4% kanë deklaruar se nuk e kanë raportuar zyrtarin pasi pagesa/dhurata është bërë si shenjë mirënjohjeje. Dhe vetëm 1% kanë deklaruar se nuk e kanë raportuar zyrtarin pasi që biznesi ka përfituar nga pagesa/dhurata/favoret.

Bizneseve u është kërkuar gjithashtu që të cekin arsyet për dhënien e ryshfeteve ose dhuratave. Arsyet kryesore të raportuar ishte që: i) të përshpejtojnë procedurat (20%), ii) të shmangin pagesën e gjobës (12%), iii) të ju mundësohet përfundim i një procedure (që përndryshe nuk do të ishte e mundur) (6%), iv) të zvogëlojnë koston e ndonjë procedure (5%), v) të marrin trajtim preferencial (p.sh. të iu zvogëlohen taksat, etj.) (4%), vi) të marrin informata për ndonjë proces (4%), vii) të arrijnë avantazh ndaj konkurrentëve (3%). Rreth 46% nuk i dinin arsyet.

Sa i përket metodës së përdorur për të kërkuar pagesën, rreth 18% e të anketuarve deklaruan se asnjë zyrtar nuk u ka kërkuar por ata e bërë ofertën për të lehtësuar/përshpejtuar ndonjë procedurë, 25% kanë deklaruar se kërkesa ishte bërë indirekt (15% thanë se zyrtari kërkoi pagesë në mënyrë indirekte dhe 10% deklaruan se një person i tretë ka kërkuar paratë), 10% kanë deklaruar se ishte një kërkesë direkte nga zyrtari publik dhe 47% nuk e dinin. Rezultatet tregojnë se 18% ose çdo i gjashti biznes jep para një zyrtari publik pa kërkuar zyrtari. Bizneset e bëjnë një gjë të tillë në mënyrë që të përshpejtojnë procedurat. Kjo krijon një konkurrencë të pandershme pasi bizneset që paguajnë ryshfet mund të përfundojnë duke përfunduar procedura shumë më shpejt se bizneset që nuk paguajnë ryshfet. Për më

tepër, bizneset e të tilla e promovojnë korrupsionin pasi janë ato që ofrojnë para.

Pothuajse 21% e bizneseve që kanë marrë një kërkesë nga një zyrtar publik për ryshfet ose dhurata kanë deklaruar se nuk pranuan të japin asgjë. Ndërkohë 56% nuk refuzuan dhe 22% e të anketuarve nuk ishin në dijeni. Kjo tregon se çdo i dyti biznes që merr një kërkesë për të dhënë para ose dhurata një zyrtari publik vendos ta bëjë një gjë të tillë. Bizneset mund të vendosin të japin paratë pasi besojnë se nëse nuk japin ryshfet atëherë ata nuk do të jenë në gjendje ta kryejnë punën e tyre. Më tej, ata gjithashtu mund të mendojnë se edhe nëse vendosin të mos japin para dhe të raportojnë zyrtarin, asgjë nuk do t'i ndodhë zyrtarit.

Për të kuptuar sa biznese japin ryshfet përpara se të ju kërkohej nga një zyrtar publik, ekipi e ka parashtruar pyetjen në mënyrë indirekte duke u kërkuar kompanive të deklarojnë përqindjet e kompanive të cilat veprojnë në sektorin e tyre që japin ryshfete edhe nëse nuk kërkohen nga zyrtarët publikë. Rezultatet tregojnë se mesatarisht 20% e kompanive japin ryshfete pa u kërkuar një gjë e tillë nga zyrtari publik. Ky rezultat është shqetësues pasi që tregon se çdo e pesti biznes vendos të paguajë ryshfet ose t'i japë një dhuratë një zyrtari publik pa ju kërkuar.

Lidhur me refuzimin nga zyrtarët publik për të marrë ryshfet ose para, bizneset deklaruan se mesatarisht 18% e zyrtarëve publikë do të refuzonin të pranojnë ryshfetin/dhuratën nëse iu ofrohet. Një rezultat i tillë tregon se bizneset besojnë se një numër shumë i lartë i zyrtarëve publikë janë të korruptuar. Ky perceptim shtyn bizneset që të mos shqetësohen për procedurat administrative pasi që ata e dinë se mund të ofrojnë ryshfete zyrtarëve publikë. Kjo çon në një konkurrencë të pandershme që mbizotëron në Kosovë për një kohë të gjatë dhe është duke u renditur si një nga barrierat më të mëdha për të bërë biznes.

5.2.6 Sjellja e bizneseve ndaj korrupsionit dhe gatishmëria për ti implementuar principet etike


Ky seksion do të fokusohet në përshkrimin e qëndrimeve të bizneseve ndaj korrupsionit. Për më tepër, ky seksion do të prezantojë gatishmërinë e bizne-

seve për të nënshkruar Kodin kundër Korrupsionit, dhe për të implementuar principet etike në biznes.

Rreth 12% e bizneseve kanë deklaruar se gjatë tri viteve të fundit kanë vendosur të mos bëjnë investime të mëdha, për shkak të frikës së dhënies së mitos apo dhuratave për të marrë në shkëmbim shërbimin/lejen e nevojshme. Në ndërkohë, 88% kanë deklaruar se nuk përballen me një frikë të tillë. Kjo tregon se një në çdo dhjetë biznese mund të vendosë të mos investojë për shkak të frikës së dhënies së parave apo dhuratave zyrtarëve publik. Biznese të tilla nuk arrijnë të zhvillohen, dhe si rezultat nuk krijojnë vende të reja të punës.

Gati 91% e të anketuarve pajtohen, ose pajtohen deri në një farë mase me deklaratën se korrupsioni në Kosovë është i përhapur për shkak të kërkesave dhe kushtëzimeve të vendosura nga zyrtarët publik (shih Fig. 11 për detaje). Në ndërkohë, rreth 83% e të anketuarve pajtohen, ose pajtohen deri në njëfarë mase se korrupsioni në Kosovë është i përhapur kryesisht për shkak të bizneseve që insistojnë tu japin para apo dhurata zyrtarëve publik. Rreth 90% pajtohen, ose pajtohen deri në njëfarë mase me deklaratën se korrupsioni në Kosovë është i përhapur kryesisht për shkak të kërkesave nga ana e zyrtarëve publik dhe ofrimeve të parave dhe dhuratave nga bizneset.

FIGURA. 11 NIVELI I PAJTUESHMËRISË ME DEKLARATAT E NDËRLIDHURA ME KORRUPSION



BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE

Sa i përket principeve të etikës, disa biznese kanë zhvilluar rregullore për të luftuar korrupsionin. Për shembull, 62% e bizneseve kanë deklaruar se kanë Kod të Etikës të cilit punëtorët duhet t'i përmbahen. Ndërkohë, 27% e bizneseve kanë deklaruar se kanë një rregullore e cila u ndalon punëtorëve të biznesit dhënien e mitos. Bizneset të cilat nuk kanë rregullore, janë pyetur nëse do të ishin të gatshëm të angazhohen në hartimin e një rregullore e cila ndalon dhënien e mitos, dhe 76% janë përgjigjur se janë të gatshëm të bëjnë një gjë të tillë, ndërsa 8%


kanë deklaruar se nuk janë të gatshëm. Nga bizneset që janë shprehur të gatshme të angazhohen në krijimin e një rregulloreje, 78% kanë deklaruar se menaxhmenti i lartë i tyre do të ishte i gatshëm të krijonte dhe ndante përgjegjësi të qarta në mënyrë që të sigurohej se rregullorja do të zbatohet, dhe 67% kanë deklaruar se biznesi i tyre do të ishte i gatshëm të instalonte një sistem që vazhdimisht monitoron implementimin e programit kundër korrupsionit, dhe 10% deklaruan se nuk do të ishin të gatshëm të bënin një gjë të tillë. Tutje, 58% deklaruar

an se biznesi i tyre do të ishte i gatshëm të ndajë resurset e nevojshme për programin, dhe 17% nuk do të ishin të gatshëm të ndanin resurse. Përveç kësaj, rreth 24% e bizneseve kanë deklaruar se ata kanë procedura tjera disiplinore për të trajtuar çdo incident të mundshëm ryshfeti, dhe 66% nuk kanë ndonjë procedurë tjetër. Nga ato biznese që nuk kanë procedura që merren me raste të ryshfetit, 69% kanë deklaruar se do të ishin të gatshëm për të hartuar rregullore për trajtimin e incidenteve të ryshfeti, ndërkohë 15% kanë deklaruar se nuk do të ishin të gatshëm. Ndërkohë, sa i përket dhënies së dhuratave zyrtarëve publik, rreth 16% kanë

deklaruar se ata kanë një rregullore për këtë gjë, dhe 77% nuk e kanë. Ngjashëm, gati 13% e bizneseve kanë deklaruar se ata kanë një rregullore rreth kontributeve ndaj partive politike, dhe 21% kanë një rregullore rreth donacioneve dhe sponsorizimeve.

Rreth 96% e bizneseve janë pajtuar në deklaratën se përfshirja në afere korruptive dëmton imazhin e biznesit. Tutje, 97% e të anketuarve deklaruan se është e rëndësishme për ta si liderë/udhëheqës të lartë të nxisin/ndërtojnë një kulturë të integritetit moral e profesional në biznes.

FIGURA. 12 PËRFSHIRJA NË PRAKTIKA KORRUPTIVE NJJLLOS REPUTACIONIN E BIZNESIT




BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE

Vetëm 6% e të anketuarve kanë deklaruar se ata kanë pasur raste kur kanë iniciuar procedura disiplinore ndaj ndonjë punëtori në biznesin e tyre, si rezultat i përfshirjes në afere korruptive, ndërkohë 94% kanë

deklaruar të mos kenë pasur raste të tilla. Nga bizneset që kanë pasur raste të tilla, 46% e tyre e kanë përjashtuar punëtorin, 29% kanë marrë masa disiplinore, dhe 17% i kanë njoftuar autoritetet kompetente.

FIGURA. 13 PASOJAT PËR PUNËTORËT TË CILËT KANË QENË TË PËRFSHIRË NË PRAKTIKA KORRUPTIVE



BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE

Sa i përket korrupsionit në sektorin privat, 43% e bizneseve besojnë se korrupsioni është prezent në relacionet biznesore ndërmjet bizneseve në sektorin privat. Një shifër e tillë është shumë e lartë, pasi që tregon se perceptimi është që çdo i dyti biznes është i përfshirë në praktika korruptive me ndonjë biznesin tjetër. Dhe arsyt kryesore për korrupsion në sektorin privat janë: i) dhënia e informatave konkurrentëve të cilët do të mund ta dëmtojnë biznesin (57%), ii) marrja e parave në mënyrë që të blihen produkte/shërbime të një kompanie të caktuar (28%), iii) pranimi i parave në mënyrë që të shiten produkte/shërbime të një kompanie (10%).

Kur bëhet fjalë për ndërgjegjësimin rreth Kodeve të Etikës, rreth 17% e bizneseve janë të vetëdijshëm se disa nga Asociacionet e Bizneseve në Kosovë, kanë krijuar Kode të Etikës të cilat i ndalojnë bizneset të cilat janë anëtare të Asociacioneve, që

të përfshihen në afere korruptive. Ndërkohë, rreth 47% nuk ishin të vetëdijshme, dhe 36% nuk dinin asgjë rreth temës. Kjo tregon se ka një mungesë njohurish sa i përket një iniciative të tillë nga Asociacionet e Biznesit.


Megjithatë, gati 68% e bizneseve do të ishin të gatshme që lidhësi i tyre të tregojë angazhim aktiv ndaj një programi kundër korrupsionit, dhe të veprojnë si një shembull për transparencë dhe integritet, dhe 26% do të ishin të gatshëm të angazhoheshin pjesërisht. Ka ende disa biznese të cilat hezitojnë të përkushtohen, mirëpo shumica janë të gatshme të përfshihen në një program kundër korrupsionit. Kur krahasohen për nga madhësia e biznesit, mikro-bizneset nuk tregojnë diferencë nga rezultatet e përgjithshme, por diferenca mund të vërehet tek bizneset e vogla dhe të mesme, pasi që rreth 75% e bizneseve të vogla, dhe

56% e bizneseve të mesme do të ishin të gatshme të përkushtoheshin.

Për më shumë, 66% e bizneseve kanë deklaruar se janë të gatshëm të bëjnë ndryshime në praktikat e tyre të menaxhimit të burimeve njerëzore, në mënyrë që të reflektojnë përkushtimin e biznesit të tyre ndaj programit Kundër Korrupsionit, dhe 25% do të ishin të gatshëm të bënin një gjë të tillë pjesërisht. Përveç kësaj, 68% do të ishin të

gatshëm të ofronin kanale të sigurta përmes së cilave punëtorët dhe të tjerët do të mund t'i ngri- sin shqetësimet rreth korrupsionit, pa pasur rrezik nga ndëshkimi; dhe 24% do të ishin të gatshëm por pjesërisht. Ngjashëm, rreth 63% e bizneseve kanë deklaruar se do të ishin të gatshëm të raportonin publikisht në përpjekjet e biznesit të tyre kundër korrupsionit, dhe 24% deklaruan se ata do të ishin të gatshëm të përkushtoheshin pjesërisht.

FIGURA. 14 GATISHMËRIA E BIZNESEVE PËR TË LUFTUAR KORRUPSIONIN




BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE

Pjesa më e madhe e bizneseve, 88%, nuk janë pjesë e asnjë asociacioni të biznesit. Nga bizneset që janë pjesë e asociacioneve, 80% do të ishin të gatshme të nënshkruanin një Kod të Etikës, ku do të zotoheshin se biznesi i tyre nuk do të përfshihet në afera korruptive, dhe do t'i zbatoj parimet etike kundër ryshfetit. Sa i përket efektivitetit të komunitetit biznesor (bizneset, odat dhe asociacionet) për të luftuar korrupsionin përmes nënshkrimit të Kodit të Etikës, rreth 71% e të të anketuarve kanë deklaruar se do të ishte efektive (37%-shumë efektive, dhe 34%-efektive). Ndërkohë, 22% mendojnë se do të ishte pak efektive.

Lidhur me pasojat me të cilat mund të ballafaqohen bizneset të cilat përfshihen në praktika korruptive, 54% besojnë që është e mundshme ose shumë e mundshme (shih Fig. 15 për detaje) që ata do të kapeshin dhe do të raportoheshin në polici ose prokurori. Ndërkohë, 46% mendojnë se është e pa-

mundur ose shumë e pamundur. Rezultate të tilla tregojnë që thujse çdo i dyti biznes mendon që gjasat që të kapen gjatë përfshirjes në praktika korruptive janë të vogla. Kjo do të mund ti motivonte ata që të përfshihen në sjellje të tilla, në mënyrë që të fitojnë përparësi ndaj konkurrentëve, pasi që do të dinin se gjasat për tu kapur janë thujse minimale. Ngjashëm, 46% mendojnë se është e mundshme ose shumë e mundshme për një biznes që është i përfshirë në sjellje korruptive që të kapet dhe të dënohet, ose edhe të kalojë kohë në burg përmes një dënimi gjyqësor. Ndërkohë, 54% besojnë që një gjë e tillë është e pamundur të ndodhë. Në linja të njëjta, 44% besojnë se është e mundshme ose shumë e mundshme që bizneset të cilat përfshihen në sjellje korruptive do të humbnin licencën e tyre; 56% mendojnë se është e pamundur. Po ashtu, rreth 54% besojnë se është e mundur që bizneset të futen në listë të zezë, ndërkohë 45% besojnë se një gjë e tillë është e pamundur.

FIGURA. 15 PASOJAT E ZYRTARËVE BIZNESORË QË PËRFSHIHEN NË PRAKTIKA KORRUPTIVE




BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE

Në pyetjen nëse njerëzit apo bizneset të cilat janë të përfshira në praktika korruptive, kapen dhe dënohen siç duhet, 55% nuk pajtohen me deklaratën, 39% pajtohen deri në njëfarë mase, dhe vetëm 6% pajtohen plotësisht. Ndërkohë, kur pyeten nëse njerëzit

dhe bizneset të cilën kapen duke i dhënë rryshfet një zyrtari të lartë dënohen ashtu siç duhet, 60% nuk pajtohen me deklaratën, 35% pajtohen deri në një masë, dhe 5% pajtohen.

FIGURA. 16 NIVELI I PAJTUESHMËRISË ME DEKLARATAT E NDËRLIDHURA ME KORRUPSION



BURIMI: KALKULIMET E AUTORËVE

Tutje, në pyetjen nëse biznesi i tyre ka qenë i përfshirë në ndonjë rast gjyqësor për afere korruptive (qoftë si të pandehur apo të akuzuar), saktësisht 6% kanë deklaruar të kenë qenë të përfshirë, dhe për 86% të bizneseve arsyeja e përfshirjes është

se biznesi i tyre ka iniciuar rastin në gjykatë pasi që kanë besuar ju është bërë një padrejtësi ndërsa 14% kanë deklaruar se ndaj biznesit të tyre janë ngritur akuza për përfshirje në afere korruptive.



6. PËRFUNDIME MBI TË GJETURAT E ANKETËS

Perceptimi i përgjithshëm i 500 bizneseve të anketuara, tregon se ka një konsensus se korrupsioni në shoqërinë kosovare është mjaft i përhapur, me fokus kryesor në institucionet qendrore, prokurim publik, dhe në marrjen e lejeve të ndërtimit dhe licencave. Thujse dy të tretat e bizneseve konsiderojnë se nuk ka shërbim që është i ndërlidhur me institucione publike, që mund të merret pa dhënë ryshfet.

Për më shumë, rreth 73% e bizneseve konsiderojnë korrupsionin si një problem serioz për kryerjen e veprimtarisë biznesore. Vetëm 27% e tyre e mohojnë se është problem. Megjithatë, vetëm gjysma e bizneseve të anketuara konsiderojnë korrupsionin të jetë i përhapur në sektorin ku ata operojnë. Tutje, bizneset mendojnë se rreth 25% e kompanive në sektorin e tyre janë të përfshira në afera korruptive.

Vetëm 36 biznese, apo rreth 7% e bizneseve të anketuara, kanë deklaruar të kenë pranuar kërkesa nga zyrtarët publik për ryshfet, në shkëmbim të një shërbimi apo problemi për tu zgjidhur, dhe vetëm 10% kanë raportuar rastet tek autoritetet kompetente. Për më shumë, 40% e të anketuarve kanë deklaruar se asgjë nuk ka ndodhur me zyrtarët të cilët janë raportuar. Në linja të përafërta, edhe 26% e bizneseve kanë deklaruar se nuk ka kurrfarë kuptimi të raportohen zyrtarët, pasi që askush nuk do të merret me rastin. Gjithashtu, më shumë se gjysma e bizneseve besojnë se zyrtarët të cilët janë kapur duke u përfshirë në praktika korruptive, nuk janë dënuar në mënyrë të duhur, pasi që nuk janë

dënuar me burg; duke treguar në këtë mënyrë se bizneset besojnë që dënimet për korrupsion nuk janë adekuate. Vetëm 6% e të anketuarve kanë qenë të përfshirë në procedura gjyqësore të ndërlidhura me korrupsion, gjatë tre viteve të fundit, prej të cilave 79% kanë iniciuar rastet pasi që kanë besuar se i ju është bërë e padrejtë.

Një gjetje tjetër është se rreth 20% e bizneseve u ofrojnë ryshfet ose dhuratatë zyrtarëve publik, pa ju kërkuar zyrtarët një gjë të tillë. Një rezultat i tillë tregon se një në çdo të pestin biznes, është i pari që i ofron ryshfet një zyrtari publik. Kjo mund të jetë për shkak të perceptimit që asnjë shërbim nuk mund të merret pa paguar ryshfet. Bizneset mendojnë se vetëm 18% e zyrtarëve publikë të cilëve u ofrohet ryshfet, do ta refuzonin; duke treguar se gati 82% e zyrtarëve publik do të pranonin ryshfet nga bizneset private.

Bizneset mendojnë se korrupsioni në Kosovë është i përhapur për shkak të zyrtarëve të cilët kërkojnë ryshfet, dhe gatishmërisë së bizneseve për t'ju dhënë ryshfet ose dhurata. Sa i përket asaj se si duhen përfaqësuesit biznesor të reagojnë kur zyrtarët publikë kërkojnë ryshfet nga ta, rreth 42% konsiderojnë se përfaqësuesit biznesor duhet të refuzojnë kërkesën menjëherë; dhe 43% e tyre mendojnë se bizneset duhet të raportojnë zyrtarin tek autoritetet kompetente. Ndërkohë, 6% mendojnë se një kërkesë e tillë duhet të pranohet nga bizneset.

Lidhjet e afërta ndërmjet bizneseve dhe politikës, shihen si burim kryesor i korrupsionit nga gati 91% e bizneseve, duke e bërë korrupsionin në këtë mënyrë një parakusht për të bërë biznes në Kosovë.

Ekziston pothuajse një konsensus i plotë tek të anketuarit, sa i përket pasojave negative që korrupsioni ka mbi konkurrencën e drejtë dhe të barabartë, zhvillimin ekonomik, investimet dhe në imazhin e biznesit. Megjithatë, gati gjysma e bizneseve të intervistuar konsiderojnë se zhvillimi afat-gjatë i biznesit mund të arrihet përmes korrupsionit.

Më pak se një e pesta e bizneseve, kanë rregulluar procedurat disiplinore dhe masat që ndalojnë dhe sanksionojnë korrupsionin. Por ka një nivel të lartë të gatishmërisë për ta rregulluar këtë në të ardhmen. Rreth 80% e tyre do të nënshkruanin Kodin e Biznesit kundër Korrupsionit, përderisa 70% mendojnë se ky kod do të kishte efekte pozitive në luftimin e korrupsionit.



7. DISPOZITAT KYÇE TË KODIT TË BIZNESIT KUNDËR KORRUPSIONIT

Duke ndjekur praktikat e avancuara në implementimin e standardeve etike në të bërit biznes, dhe po ashtu duke konsideruar se rreth 80% e bizneseve të anketuara (Riinvest 2019) kanë shprehur gatishmëri për të nënshkruar dhe implementuar Kodin e Biznesit kundër Korrupsionit (KBKK), në vijim prezantojmë dispozitat kyçe dhe principet që do të shërbejnë për të formësuar këtë kod, në konsultime me hisedarët kryesorë, respektivisht asociacionet e biznesit. Përmes KBKK-së, asociacionet dhe udhëheqësit e bizneseve do të shprehin gatishmërinë dhe përkushtimin që:

- Në rregulloret, politikat dhe procedurat e biznesit, të zhvillojnë standarde të integritet që shërbejnë si kode të sjelljes për punëtorë në të cilat ceket qartë përkushtimi i pronarëve, drejtorëve dhe punëtorëve drejt standardeve dhe integritetit: të bërit biznes në mënyrë të drejtë, të sqartë dhe të hapur.
- Të reflektojnë ndalimin e dhënies së ryshfetit në rregulloret e biznesit dhe të krijojnë një sistem për raportimin të ryshfetit, i cili do të ekzaminojë dhe të menaxhojë përpjekjet kundër ryshfet, në baza të rregullta, duke përfshirë rishikimin e shpenzimeve buxhetore të ndërlidhur me projektet të cilat përfshinë punën me institucionet qeveritare.
- Të krijohen standardet të brendshme të kontrollit të auditimit, të cilat do të reflektojnë standardet kundër ryshfetit dhe do të bëjnë transparent raportin e auditorit.
- Të theksojë qartë se të gjitha kërkesat për korrupsion (direkte dhe jo-direkte) nuk do të pranohen dhe do të raportohen tek autoritetet kompetente.
- Do të implementojnë rregullore në shmangien e konfliktit të interesit.
- Do të zhvillojnë udhëzues për të shpërblyer dhe ndëshkuar punëtorët e ndërlidhur me ryshfet, duke u ofruar stimuj atyre që kanë kontribuar ndaj luftimit të korrupsionit, dhe duke vendosur dënime adekuate për ata që kanë shkelur rregullat e brendshme.
- Të pranojnë standardet e transparencës, sidomos në prokurim publik, duke përfshirë monitorimin e procedurave dhe implementimin e kontratave të ndërlidhura me prokurim publik.
- Të implementojnë transparencë të plotë dhe principe etike për kontributet ndaj partive politike dhe sponsorizime, dhe të mbajnë shënime për të gjithë kontributet e bëra për këtë qëllim.

- Të zhvillojë plane të detajuara edukimi kundër korrupsionit për punëtorët.
- Do të shmangin bërjen e biznes me ata të cilët nuk i pranojnë vlerat dhe të cilët mund të dëmtojnë reputacionin e biznesit, dhe të cilët shkelin dispozitat e KBKK-së.
- Do të qëndrojnë prapa principeve të OECD-së për qeverisje korporative dhe përgjegjësi sociale korporative, të cilat do të kontribuojnë në mbrojtjen e reputacionit të biznesit dhe të marrëdhënieve profesionale me hisedarët, punëtorët, furnitorët, nën-kontraktorët, konkurrentët, konsumatorët, dhe qeverinë.



8. REFERENCES

Anti-Corruption & Civil Rights Commission, (2016). Anti-Corruption Guidelines for Companies. Available at: www.acrc.go.kr

Australian Institute. (2018). The Cost of the Corruption

DFID. (2015). Why Corruption Matters: Understanding Causes, Effects and How to Address Them.

European Parliamentary Research Service. (2017). Corruption in the European Union: Prevalence of corruption, and anti-corruption efforts in selected EU Member States.

GAN, Business Anti-corruption Portal. (2017). Serbia Corruption Report. Retrieved from: <https://www.business-anti-corruption.com/country-profiles/serbia/>

GAN, Business Anti-corruption Portal. (2018). Macedonia Corruption Report. Retrieved from: <https://www.business-anti-corruption.com/country-profiles/macedonia/>

GAN, Business Anti-corruption Portal. (2015). Montenegro Corruption Report. Retrieved from: <https://www.business-anti-corruption.com/country-profiles/montenegro/>

GAN, Business Anti-corruption Portal. (2017). Croatia Corruption Report. Retrieved from: <https://www.business-anti-corruption.com/country-profiles/croatia/>

GTZ. (2008). Costs of Corruption “Everyone Pyas- And the Pour More than Others”.

HM Government. (2017). United Kingdom Anti-Corruption Strategy 2017-2022. Retrieved from <https://www.gov.uk/government/publications>

Organization for Economic Cooperation and Development. (2016). OECD Strategic Approach to Combating Corruption and Promoting Integrity.

Organization for Economic Cooperation and Development. (2008). Fighting Bribery in International Business Deals.

OECD, UNODC, & World Bank. (2013). Anti-Corruption Ethics and Compliance Handbook for Business.

Regional Academy of the United Nations. (n.d.). Private Sector and Civil Society Partnerships against Corruption in South-eastern Europe. Authors: Anita Markos, University of Szeged, Thi Hoang, Vienna University of Economics and Business. Contributor: Alexandra Sarinova, Diplomatic Academy of Vienna

Sikka, P., & Lehman, G. (2015). The supply-side of corruption and limits to preventing corruption within government procurement and constructing ethical subjects. *Critical Perspectives on Accounting*, Vol. 28, May 2015, pp 62-70.

Transparency International. (2015). *The State of Corruption: Armenia, Azerbaijan, Georgia, Moldova and Ukraine*. ISBN: 978-3-943497-83-0. Retrieved from www.transparency.org

Transparency International. (2008). *Business Principles for Countering Bribery: Small and Medium Enterprise (SME) Edition*. ISBN: 978-3-935711-05-0

UNDP. (2019). Public Pulse XV. Retrieved from http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/operations/projects/democratic_governance/PublicPulse.html

Vilnius, (2015). Resolution Regarding the Approval of the Interinstitutional Action Plan for the Implementation in 2015-2019 of the National Anti-Corruption Programme of the Republic of Lithuania for 2015-2025. APPROVED by Government of the Republic of Lithuania Resolution No. 648.

Wei, S. (2001). *Corruption in Economic Transition and Development: Grease or Sand?* Geneva: United Nations Economic Commission for Europe.

Ky grant është mundësuar nga 'Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën', financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA). Përmbajtja dhe rekomandimet e paraqitura nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).



Norwegian Embassy



FONDACIONI KOSOVAR PËR SHOQËRI CIVILE
KOSOVAR CIVIL SOCIETY FOUNDATION